

1 E martë, 7 dhjetor 2021

2 [Seancë e hapur]

3 [I Akuzuari Gucati hyn në sallën e gjyqit]

4 [I Akuzuari Haradinaj paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 9.29

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirëdita
8 të gjithëve. Zonja Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
10 kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-07, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
13 ndryshim në përbërjen e ekipeve?

14 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Për ZPS-
15 në e pranishme sot është edhe Molly Norburg, stazhiere
16 juriste.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
18 Faleminderit. Z. Rees ka ndonjë ndryshim?

19 Z. REES: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Cadman,
21 ka ndryshim në grupin tuaj?

22 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
24 Faleminderit.

25 Z. Gucati është i pranishëm në sallë, është në bankën e

1 dëshmitarëve dhe është i gatshëm të vijojë.

2 Z. Haradinaj është i pranishëm online.

3 Z. Haradinaj, është në rregull që mund të na ndiqni nga
4 larg?

5 I AKUZUARI HARADINAJ: [Përmes videolidhjes] Po, po. Nesër
6 pastaj do të jem atje.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

8 Faleminderit zoti Haradinaj.

9 Z. Rees mund të vazhdoni nëse keni pyetje.

10 Z. REES: [Përkthim] dua të ngre dy çështje lidhur me
11 administrimin. Në një moment të përshtatshëm sot, jo medoemos
12 tani, sepse e kuptoj që dëshirojmë të vazhdojmë me dëshminë po
13 në një moment të caktuar dua që të ngre çështjen e afateve sa
14 i takon zgjidhjes së çështjeve të rregullit 102(3) dhe
15 gjithashtu dua të diskutojmë edhe për qasjen tonë të propozuar
16 për dëshmitarët e tjerë të mbetur të Mbrojtjes, qoftë edhe për
17 të marrë ndonjë udhëzim nga ana juaj sa i takon planifikimit
18 tonë për këtë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Patjetër,
20 mbase mbas pushimit të drekës mund të vazhdojmë me këtë nëse
21 nuk ka kundërshtim Prokuroria.

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Në rregull i nderuar Gjykatës.
23 Edhe ne kemi një çështje për ta paraqitur para jush lidhur me
24 kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt për leje për apelim, e cila
25 është protokolluar dje me numër 474 [sipas përkthimit].

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 3

1 Duke pasur parasysh paragrafin 120 të Vendimit të Trupit
2 Gjykues me numër 407 [sipas përkthimit], ZPS-ja nuk do
3 kundërshtojë kërkesën për leje për apelim dhe nuk kemi
4 ndërmend që të parashtrijmë parashtrime me shkrim për këtë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

6 Faleminderit shumë.

7 Zonja Prokurore mund të vazhdoni me kundërpjetjet tuaja.

8 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

9 DËSHMITARI: HYSNI GUCATI [Vijon]

10 Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici:

11 [Vazhdim]

12 Py. Z. Gucati, mirëdita.

13 Pë. Mirëdita.

14 Py. Z. Gucati, në lidhje me paketën e parë të dokumenteve që
15 ju e shpërndatë në konferencën për shtyp më datë 7 shtator
16 2020, ju ishit në dijeni se këto ishin dokumente të Task
17 Forcës Hetimore Speciale apo të ZPS-së, kështu është?

18 Pë. Ne për fillim s'e kemi ditë se janë të Gjykatës Speciale
19 ato dokumenta, ne kemi thënë në media. Këtu duhen verifikuar
20 këto dokumentacione a janë të Gjykatës Speciale apo nuk janë,
21 kështu kemi thënë edhe në fillim.

22 Py. Dhe kur i patë, këqyrët dokumentet përpara Konferencës
23 për Shtyp, a e kuptuat që këto ishin dokumente të Task Forcës
24 Hetimore Speciale apo të ZPS-së?

25 Pë. Më vonë nuk i kemi kontrolluar këto dokumenta na deri në

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 4

1 fund, se ka qenë një grumbull i dokumentacionit siç janë
2 theksu edhe ma herët afër rreth katër mijë dokumenta. Aty ka
3 pasë dokumentacione edhe të ish-Gjykatës Speciale për Krime
4 Luftë në Jugosllavi, kështu që ne prapë po të thom që nuk e
5 kemi ditë që kanë qenë edhe të Gjykatës Speciale derisa
6 hetusët e juve e kanë pranë që janë të Gjykatës Speciale në
7 ditën [e pakuptueshme].

8 Py. Në rregull. Z. Gucati, po mbështetem tek paragrafi 14 i
9 deklaratës suaj, me numër DHG0472-DHG0493. Deklaratën tuaj e
10 keni përpara?

11 Pë. Jo.

12 Py. A mundet, nëse është e mundur që të nxjerrim në ekran
13 versionin në shqip të deklaratës?

14 Z. REES: [Përkthim] Jam në dijeni që versioni i shtypur
15 në letër që përdorte zoti Gucati, më duket se e ka marrë
16 Sekretarja e Gjykatës në fund të procedurës. Nëse mund t'ia
17 kthejmë do ishte mirë.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, e kërkojmë.

19 ZNJ. BOLICI: Do të doja që dëshmitari të ketë mundësinë
20 të shikojë deklaratën. Epo ja ku është në ekran.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
22 çaktivizuar].

23 I AKUZUARI GUCATI: Nuk mund të dëgjoj.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A e shihni
25 deklaratën tuaj në ekran, zoti Gucati?

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 5

1 I AKUZUARI GUCATI: Po, i nderum.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

5 Py. Në paragrafin 14 të deklaratës suaj, thoni:

6 "Ishim duke i shikuar dokumentet dhe u siguroam se
7 dokumentet ishin nga Dhomat e Specializuara të Kosovës. E
8 kuptuam se ishin dokumente zyrtare, por aty kishte dhe
9 dokumente nga Serbia. E kuptuam se ishin dokumente me rëndësi
10 dhe ishte në interesin tonë që të kuptojmë...".

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja
12 Bolici, ndërprisni ju lutem sepse e kam dokumentin e shtypur.

13 Py. "E kuptuam se ishin dokumente me rëndësi dhe ishte në
14 interesin tonë që të kuptonim sesi kishin ardhur dokumentet në
15 zyrat tona."

16 Pra në bazë të deklaratës, ju e kuptuat që këto dokumente
17 ishin dokumente të DhSK/ZPS-së?

18 Pë. Është shumë e vërtetë në kapitullin 14 që shkrun. Kjo ka
19 qenë mbas konferencës, mbasi e kemi pa logon e Gjykatës
20 Speciale edhe ne kemi thënë. Ne dyshuam se këto dokumente mund
21 të jenë të Gjykatës Speciale. Kjo është e vërtetë që kam thënë
22 kështu, mbasi, mbas Konferencës së Parë kam thënë, është
23 reale.

24 Py. Po, po ta shihni deklaratën tuaj zoti Gucati, në
25 paragrafin e mëparshëm atë me numër 13, aty ju përcaktoni, e

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 6

1 përkruani momentin kur i keni parë dokumentet së bashku me
2 zotin Faton Klinaku, zotin Nasim Haradinaj dhe anëtarët e
3 tjerë të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, të
4 komitetit pra të kësaj organizate.

5 Në bazë të kronologjisë që ndjek deklarata duket se
6 kontroll ju e keni bërë përpara konferencës për shtyp dhe jo
7 pas konferencës për shtyp, ju kujtohet kjo?

8 Pë. Kam thënë edhe dje, kam theksu edhe sot po them, ne e
9 kemi pa dokumentacionin po nuk i kena besu vetvetes se ato
10 dokumentacione mund të rrjedhin nga Gjykata Speciale. Kjo
11 është shumë e vërtetë, kam thënë edhe po them edhe sot. Ne i
12 kemi pa ato dokumentacione po s'kemi besu deri në një kohë të
13 caktume që janë dokumentacione të Gjykatës Speciale. Shumë e
14 vërtetë është.

15 Py. Dhe kur po i shihnit këto dokumente, e vutë re që kishte
16 dokumente të nënshkruara nga Task Forca Hetimore Speciale dhe
17 nga Prokurorët e Dhomave të Specializuara të Kosovës, është e
18 saktë?

19 Pë. Jo për nënshkrime s'kam pa. Singërisht se kam vërejt
20 nënshkrimin, vetëm logon mbi dokumenta e kam pa që ka qenë
21 logoja e Gjykatës Speciale.

22 Py. Në rregull. A vutë re emra të ndryshëm të Prokurorëve të
23 ndryshëm të TFHS-së dhe të ZPS-së në dokumentet e ndryshme
24 aty?

25 Pë. Reale ato dokumentacione ne s'i kemi kontrollu të gjitha

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 7

1 nji nga nji. Unë edhe thashë edhe dje, kam thënë edhe më
2 herët, aty dikund 7-8 faqe, muj deri në 12-13 faqe kam
3 kontrollu, kam vënë re ish-Prokurorëve të Gjykatës Speciale,
4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR], po unë kam vënë re.

6 Py. Kur i patë dokumentet, a vutë re që kishte vula dhe logo
7 të TFHS-së në këto dokumente?

8 Pë. Për vula s'kam vu re. Logon po, po e kam pa, thashë edhe
9 më herët, logon po e kam pa, po vula s'i kam vërejt sinqerisht
10 se s'më ka interesu të vërej. Mu më ka interesu më shumë
11 bashkëpunimi i Gjykatës me Gjykatën Serbe, kjo më ka interesu
12 ma shumë aty çka kam pa.

13 Py. Dje na thatë se u befasuat dhe u mërzitët për shkak të
14 këtij bashkëpunimi midis TFHS-së edhe Prokurorisë Serbe,
15 kështu është?

16 Pë. Jo vetëm dje, po do të them gjithmonë, kjo është një
17 befasi. Kjo është shumë një keqardhje për neve kur një Gjykatë
18 e Kosovës, këtë Gjykatë e ka votuar parlamenti im dhe kjo
19 Gjykatë bashkëpunon me kriminelët serbë është një befasi dhe
20 një keqardhje shumë.

21 Py. Pra duke i parë dokumentet, ju e kuptuat që kishte
22 bashkëpunim midis TFHS-së dhe prokurorisë serbe, kështu është?

23 Pë. Unë e thashë edhe ma herët, ato çka e kanë bo Vladimir
24 Vukçeviçin edhe [REDAKTUAR] në bashkëpunim, po thashë atë nuk
25 e mohoj, i kam pa këto dy emra që keni bashkëpunuar me këta dy

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 8

1 persona. Njëri është, të dyja janë fytyrë publike. [REDAKTUAR]
2 është ish-Deputet i Parlamentit të Serbisë dhe Kryetar i
3 Komisionit për Krime Lufte në Serbi dhe tjetri ka qenë ish-
4 Prokuror i Gjykatës Speciale Serbe, Vukçeviçi. Kjo është
5 reale.

6 Py. Dhe ju vutë re se kishte letra që u drejtoheshin këtyre
7 individëve nga TFHS-ja?

8 Pë. Unë e deklarova edhe më herët, të gjitha letrat s'i kam
9 kontrolluar, ato çka kam pa e them me sinqeritetin më të mirë
10 të mundshëm. Unë kam pa disa letra këtu, mund të thashë 10 apo
11 20 se Gjykata Speciale i drejtohet Gjykatës Serbe dhe kërkon
12 ndihmë prej tyre bashkëpunim kjo ka qenë. Atë e kam pa po.
13 Disa takime që keni pasë me Gjykatën Serbe.

14 Py. Dhe a vutë re gjithashtu që kishte përgjigje nga
15 prokuroria serbe drejtuar TFHS-së?

16 Pë. Unë gjuhën angleze nuk e njoh, real, dhe kështu që nuk e
17 di për përgjigje a kanë kthyer ata apo ju keni kërkuar pyetje
18 prej tyre, kështu që nuk e kam lexuar sinqerisht se gjuhën
19 angleze nuk e di fare. Thashë edhe dje jam shumë i mangët në
20 këtë drejtim, nuk e njoh gjuhën angleze mirë, as mirë, as fare
21 nuk e njoh.

22 Py. A patë përgjigje në gjuhën serbe nga prokuroria serbe
23 drejtuar TFHS-së?

24 Pë. Ato çka thashë që e kom pa nënshkrimin e Vukçeviçit edhe
25 të [REDAKTUAR], po e kom pa dhe ato përgjigje nuk i kam lexuar

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 9

1 se s'më kanë interesu. Mu më ka interesu nënshkrimi dhe emri,
2 mbiemri [REDAKTUAR] kur kam pa aty që bashkëpunon me Gjykatën
3 Speciale. Kjo ka qenë.

4 Py. Po. Zoti Gucati, dua t'ju rikujtoj se i vetmi emër që ju
5 lejohet të përmendni është emri i Vukçeviçit gjatë procedurës
6 publike. Ju lutem mos përmendni emra të tjerë.

7 Tani kur patë dokumentet serbe vutë re logon e
8 prokurorisë serbe apo jo?

9 Pë. Real nuk më kujtohet për logo të Prokurorisë, por
10 dokumentat kanë qenë serbe kanë qenë kështu. Logo s'më
11 kujtohet, do të jem i sigurtë s'më kujtohet logoja që ka
12 qenë. Mund të jetë po mund s'më kujtohet.

13 Py. Dhe vutë re se korrespondenca, pra letërkëmbimi që
14 prokuroria serbe ia drejtonte TFHS-së ishte e regjistruar,
15 protokolluar nga autoritetet serbe, kështu është?

16 Pë. Unë protokollin, numrin e protokollin se kam këqyr atë,
17 me të thënë sigurisht, se mu më ka interesuar më shumë ata dy
18 bashkëpunëtorë që keni bashkëpunuar me ta Gjykata Speciale apo
19 Prokurori i Gjykatës Speciale kështu që numri apo numri rendor
20 apo protokollin i dokumentacionit fare s'më ka hy në punë se
21 s'më ka interesu ato.

22 Py. A vutë re nëse kishte ndonjë vulë apo numër reference që
23 tregonte se këto dokumente ishin të regjistruara diku nga
24 autoritetet serbe?

25 Pë. Real, tash unë, ato dokumentacione nuk i kom çu në

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 10

1 ekspertizë që t'i këqyrim. Ato u dashtë me bo ekspertizën e
2 atyne, në a janë të vërteta të Serbisë apo të kujna janë,
3 kështu që unë ato në ekspertizë nuk i kam çu edhe pse e kam
4 kërkuar edhe nga policia e Kosovës edhe nga hetuesët e Kosovës
5 dhe nga hetuesët e juj që t'i marrin këto dokumentacione dhe
6 të bëjnë verifikimin e tyne a kanë rrjedhë nga ju apo nga
7 Serbia, kështu që, jo nuk e di, veç me e ditë që
8 bapushkëpunimi kish qenë mes Gjykatës Speciale dhe Prokurorisë
9 Serbe, kjo është reale.

10 Pë. Faleminderit.

11 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj t'i tregojmë dëshmitarit
12 provën me numër P0009-80, ka përkrah me numër P00009-ET [sipas
13 përkthimit], në veçanti faqen 6.

14 Py. Z. Gucati, po të shihni rreshtin 7 të këtij teksti të
15 zbardhur, që është teksti i zbardhur i një interviste, pra
16 është zbardhja e një interviste të cilën ju i keni dhënë
17 pasdreken e datës 7 shtator programit televiziv "Imazh" këtu
18 keni thënë:

19 "Në bazë të këtyre këto janë dokumente të prokurorisë
20 serbe në ato dokumente me vulë dhe stemë të Serbisë në gjuhën
21 cirilike që unë e njoh mirë se kam qenë ish-ushtar në ish-
22 Jugosllavi në vitet që [nuk dëgjohen mirë] dhe di pak të
23 lexoj".

24 Z. REES: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres po
25 rreshti 7 Prokurore, e ka fjalën për përkthimin në gjuhën

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 11

1 angleze. Mundet zonja Bolici të na japë referencën se ku
2 ndodhet në gjuhën shqipe ky rresht të cilën ajo po e lexon?

3 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ju lutem mund të shihni "Gucati"
4 në rreshtin 12. Pra unë po filloja të lexoja në gjuhën shqipe
5 Py. D.m.th. në gjuhën shqip është në rreshtin 12 që përkon me
6 gjuhën angleze ne rreshtin 7.

7 I AKUZUARI GUCATI: A ka mundësi ta lexojmë në rreshtin
8 numër 7, tani të shkojmë tek rreshti 12, zonja Prokurore mbasi
9 s'e kam lexu çka kam thënë në rreshtin numër 7, kështu që, me
10 ditë gjyqtarët.

11 Thashë ne verifikime s'kemi bërë në mënyrë zyrtare. Nuk
12 guxoj të them asgjë, as për fallsifikim apo origjinali i
13 këtyre dokumentacioneve kështu kam thënë në rreshtin numër 7.
14 Py. Z. Gucati është tjetër pyetje tani. Në paragrafin që
15 fillon në rreshtin 12 a keni thënë se ka dokumente të
16 prokurorisë serbe me vulë dhe stemë të Serbisë në gjuhën
17 cirilike, pra e pranoni që e keni thënë këtë?

18 Pë. E kam thënë në bazë të dokumentacioneve. Fort mirë, në
19 bazë të dokumentacioneve të prokurorisë së serbisë. Është e
20 vërtetë që e kam thënë në bazë të dokumentacioneve ka. Po kam
21 thënë edhe në rreshtin 7 që këto dokumente se kam bo
22 verifikimin e këtyre unë, kështu që duhet ekspertizë për këto
23 dokumente, kështu kam thënë në rreshtin numër 7 edhe në
24 rreshtin numër 12 në bazë të dokumentacioneve kam thënë
25 gjithmonë.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 12

1 Py. Po, vërtet. Kur i patë dokumentet, ju patët mundësi që të
2 përqendroheshit në faktin që kishte stema dhe vula serbe,
3 kështu është, serbisht pra, kështu është?

4 Pë. Jo mundësi s'kemi pasë se po të kishim mundësi ne e kemi
5 mbajt konferencën mrena dy-tri orëve, unë do t'i kisha ndru të
6 gjitha rend, kështu që jo, kanë ardhur i kanë marrë të
7 nesërmen hetuesit e Gjykatës Speciale dokumentacionin. E kanë
8 marrë më 8 shtator, kështu që s'kemi pasë mundësi ne ti
9 kontrollojmë.

10 Py. Por më përpara, ju i vutë re këtë vulë, më falni, këtë
11 stemë, këtë stemë, e vutë re stemën dhe për këtë stemë ju e
12 përmendët edhe në intervistën në televizion, kështu është?

13 Pë. Në televizion s'më kujtohet se e kam thënë, ka mundësi që
14 e kam thënë përmes një mediumi kështu apo portali. Po kam
15 thënë që dokumente serbe ka. A janë origjinale a nuk janë, nuk
16 jam ekspert i asaj lëmie që ta verifikoj, kështu kam thënë
17 gjithmonë. Dhe qëndroj prapa kësajna që kam thënë, ka
18 dokumentacione serbe po s'jam ekspert i atyne të verifikoj a
19 janë origjinale a s'janë, nga kanë ardhur.

20 Py. Kur thatë që kishte vula dhe stema serbe e thatë se e
21 kishit parë përpara se përndryshe nuk mund ta kishit thënë, a
22 pajtoheni me mua për këtë?

23 Pë. Jo, s'pajtoheni këtu se s'thashë unë e kam thënë e kam pa
24 vulën edhe stemën. Unë e kam parë nënshkrimin e Vukçeviçit dhe
25 [REDAKTUAR] që keni bashkëpunu, kështu kam thënë gjithmonë, e

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 13

1 them prapë. Unë vulën ato s'kam thënë, ka mundësi, në kontekst
2 të fjalës qysh është nxjerrë kjo nuk e di, po unë nuk e besoj.
3 Se unë kur them Vukçeviçin do ta përmend edhe stemën edhe
4 vulën serbe se s'e kam problem atë punë. S'e kam problem pse
5 mos ta përmendi atë, se s'e kom problem.

6 Py. E pranoni që ky teksti i zbardhur që keni përpara
7 reflekton, pra pasqyron fjalët që keni thënë ju zoti Gucati?

8 Pë. Nuk jam i sigurt. Tash unë këtu mos të gënjej unë. Mund
9 të kem thënë po unë nuk e besoj se e kom thënë, nuk jam i
10 sigurt. Tash me keqardhje po nuk jam i sigurt.

11 Py. Do të kalojmë tek video e kësaj interviste, por
12 fillimisht dua që t'ju tregoj dhe një transkript tjetër, pra
13 një zbardhje tjetër.

14 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Është prova me numër P00028-ET,
15 krah për krah nëse është e mundshme me P00028-AT, në veçanti
16 faqja 14.

17 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mundet që
18 zonja Bolici të na tregojë datën dhe orën e këtyre
19 transkripteve përpara se të kalojmë pjesët përkatëse?

20 Py. Po, kjo është një intervistë që zoti Gucati i ka dhënë
21 KTV-së më datën 22 shtator, 2020.

22 ZNJ. BOLICI [Përkthim] Po të shihni fillimisht versionin
23 në shqip, tekstin në shqip, ta kalojmë një faqe më përpara,
24 faqen 13 ju lutem.

25 Py. Z. Gucati, shihni ju lutem rreshtin 12. Pra, po të shihni

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 14

1 nga rreshti 8 e tutje në shqip që përkon në rreshtin 1 të
2 transkriptit në gjuhën angleze. Rreshti 1 i faqes 13, këtu
3 intervistuesi ju ka pyetur:

4 "Disa dokumente kanë vula zyrtare, numër protokolli të
5 prokurorit të Serbisë. A mendoni apo dyshoni se mundet edhe të
6 kenë dalë nga zyra e prokurorit në Beograd"?

7 Kësaj ju i jeni përgjigjur:

8 "Është reale që ka dhe vula zyrtare".

9 Gazetari pyet:

10 "E kam fjalën për numrin e referencës që do të thotë se
11 janë pranë nga ajo zyrë, që ju i jeni përgjigjur:

12 "Po, po, e keni të drejtë. Janë vula të protokollit me
13 data të ndryshme".

14 Në bazë të kësaj që keni thënë gjatë kësaj interviste zoti
15 Gucati duket se ju i keni parë vulat dhe numrat e protokollit
16 të dokumenteve serbe dhe e kuptuat se ishin protokolluar nga
17 prokuroria serbe, kështu është?

18 Pë. Këtë informacion që kam thënë është reale unë e kam mësu
19 përmes mediave dhe përmes gazetarëve. Se as që e kam vërejt që
20 ka vula të protokollit as që e ka numër protokolli. Kjo është
21 reale se gazetari më ka bo pyetje dhe thotë që kanë vula dhe i
22 kam thënë po. Këtë e kam dëgjuar përmes mediave që e kanë
23 marrë dokumentacionin ditën e hënë më 7 shtator dhe kjo ka
24 qenë reale. Përmes tyre e kam mësuar që ka pasë. Se unë po e
25 them sinqerisht nuk e kam pa ditën e parë që ka pasë vula. Dhe

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 15

1 është reale që këto i kam thënë përmes mediave që e kam
2 mësuar.

3 Py. Z. Gucati, ju është bërë pyetja aty nëse këto dokumente
4 ka qenë të protokolluara dhe ju keni konfirmuar që po ka vula
5 të protokollit, ka data të ndryshme. Kur i kishit parë këto
6 dokumente?

7 Pë. Dokumentet i kam pa më 7 shtator thashë edhe njëherë.
8 Vula më 7 shtator. Nuk e kam pa vulë të protokollit. Thashë
9 vulën e protokollit e kam mësuar përmes mediave kur e kam pa
10 në portale të ndryshme që ka dalë dokumentacioni me vula
11 atëherë kam mësuar që ka vula të protokollit se unë s'e kam pa
12 atë ditë s'e kam vërejt se s'isha i interesum të këqyri vulën
13 e protokollit fare.

14 Py. Informacioni që i jepni gazetarit gjatë kësaj interviste
15 përputhet me informacionin që ju i keni dhënë gazetarit ne
16 intervistën të cilën jua tregova pak më përpara, pra që ishte
17 në pasditen e datës 7 shtator pasi ia dhatë dokumentet
18 shtypit, mediave. A është e vërtetë që ju i kishit parë këto
19 vula dhe stema në momentin kur i hodhët një sy dokumenteve së
20 bashku me Nasim Haradinajn, Faton Klinakun dhe anëtarët e
21 tjerë të komitetit?

22 Pë. Kjo intervistë është në ora 11.00 apo 23.00 të mbrëmjes,
23 jo ditën po mendoj ora 13 apo 14, por është në mbrëmje mbas
24 orës 23.00 dhe unë e thashë pasi kam pa portalet që kanë dalë
25 prerë mbas konferencës disa dokumentacione në portale. Ato

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 16

- 1 kam pa dhe kam vërejt që ka vula të protokollit. Thashë kjo
2 intervistë është në ora 23.00 në mbrëmje, në televizionin
3 privat KTV "Interaktiv, biles thirret emisioni. Kjo është
4 reale që po thu ti që e kam dhënë këtë intervistë në ora
5 23.00, mbas orës 23.00 në mbrëmje.
- 6 Py. Z. Gucati, kur, më falni. Keni thënë në paragrafin 19 të
7 deklaratës suaj, nëse e keni përpara deklaratën tuaj. Në
8 konferencën për shtyp ishin katër kopje identike të
9 dokumenteve dhe ato ishin shtrirë, pra ishin vendosur dhe vënë
10 në dispozicion të shtypit dhe medias. Si e konstatuat ju se
11 kopjet e dokumenteve që iu dorëzuan OVL-UÇK-së ishin katër
12 kopje identike? Si e verifikuat këtë?
- 13 Pë. Po, është reale që kam thënë. Unë e kam thënë edhe dje në
14 hamendje kam thënë që mund të jenë diku rreth 4000 dosje apo
15 katër kopje që kanë qenë. Se ka qenë e njëjta faqe sipër
16 secilës, i njëjti mbishkrim dhe e njëjta faqe ka qenë dhe
17 kështu kemi dyshuar se ato janë të kopjume dhe janë të njëjta,
18 kjo ka qenë. Ka qenë e njëjta faqe mbi secilën kopje. Ka qenë
19 e njëjta faqe dhe kështu që kemi dyshuar se të gjitha janë një
20 kopje.
- 21 Py. Dhe për të konfirmuar se ishin katër kopje identike, patë
22 vetëm faqen e parë apo patë edhe faqet e tjera?
- 23 Pë. Po q'ato 10 faqe apo 20 faqe që kam pasë mundësinë të
24 kontrolloj, mu më kanë dalë të njëjta. Unë flas gjithmonë për
25 emrin tim dhe për punën time. Mu më kanë dalë të njëjta. Unë

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 17

1 po flas vetëm për vete.

2 Py. Pra, si e verifikuat ju që dukeshin njësoj? A i vutë të
3 gjitha këto katër kopje mbi një tavolinë, ku i patë?

4 Pë. Fort mirë shifet se është kamera në sallë atje nalt kur
5 ne i kemi shpërnda të gjitha kopjet që kanë qenë të njëjta
6 edhe në sallë. [REDAKTUAR].....

7 që ka qenë prezent kur i ka marrë, ka thënë ka dokumentacione
8 të njëjta, kjo është reale.

9 Py. Z. Gucati, pikësëpari, siç edhe ju paralajmëruam dje nuk
10 duhet të përmendni emra të punonjësve të ZPS-së në një gjyq të
11 hapur. A ka ndonjë gjë të paqartë në këtë që thamë?

12 Pë. Atëherë unë kërkoj falje pse e përmenda emrin e tijna po
13 më vjen kanjiherë në mend dhe po më duhet me e përmend emnin e
14 tijna, jo me qëllime të caktume a diçka, se atë njeri ne e
15 njofëm për burrë të mirë në të gjithë Kosovë atje. Ai njeri
16 neve s'na ka bo keq, asgjë, kështu që nuk e di pse frigohet
17 ZPS-ja për atë njeri kur ne kemi pi kafe me atë njeri po e
18 thom me sinqeritetin më të mirë të mundshëm. Kjo është arsyeja
19 pse unë e përmenda emrin e tij. Kam pi kafe me atë njëri e
20 njoh mirë kështu që nuk ka kurrëgjë të keqe pse ia përmendi
21 emnin e tijna. Thashë edhe më herët, ne e kemi kalu mirë me
22 të.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Më falni
24 zonja Bolici.

25 Z. Gucati, ju paralajmëruam disa herë edhe zonja Bolici

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 18

1 ua tha, besoj se edhe avokati juaj ua ka thënë që nuk duhet
2 t'i përdorni këto emra. A është e qartë kjo?

3 I AKUZUARI GUCATI: Faleminderit. Kërkoj falje.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do
5 përpigemi t'ju kujtojmë herë pas here në fakt që ta kujtoni.

6 Z. REES: [Përkthim] Mendoj se është e vështirë për zoti
7 Gucati ta japë dëshminë pa përdorur asnjë lloj mbështetjeje.
8 Mbase zoti Gucati mund të thotë "Oficeri X" në të ardhmen. A
9 do ta ndihmonte?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Për ne
11 është në rregull. Vetëm emrin po përpigemi ta shmangim. Dhe
12 nuk ishte fakt e nevojshme ta thonit emrin fare. E bëri vetë
13 dhe vendosi ta përdorte emrin.

14 Po ju paralajmërojmë sërish zoti Gucati, mund të përdorni
15 fjalën "X" nëse i referoheni atij personi.

16 ZNJ. BOLICI

17 Py. Zoti Gucati më duhet të përqendrohem, të fokusohem tek
18 momenti kur keni parë dokumentet që u sollën në OVL UÇK më 7
19 shtator. Ku i vendosët këto dokumente në mënyrë që t'i
20 shfletonit, që t'i shikonit?

21 Pë. Më 7 shtator këto dokumente janë vendos në zyrën time
22 qysh kanë qenë në paketë i kemi qit në tavolinën time të
23 punës. Dhe nuk i kemi shfletu. Thashë mbi 20 faqe, asnjë njeri
24 s'ka shfletu ato, kjo është reale. Kanë qenë në zyrën time,
25 prej zyrës time i kemi çu në katin e pestë ku ishin mediat dhe

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 19

1 ku kishim konferencën ne, kështu ka qenë krejt.

2 Py. Dhe këto katër dokumentet e ndryshme vendosët krah njëra-
3 tjetrës apo jo?

4 Pë. Po, shumë e vërtetë është. Po, shifet në kamera shifet,
5 po.

6 Py. Po flas për momentin para konferencës për shtyp. Për
7 momentin kur i patë dosjet, këto dokumente për të konstatuar
8 çfarë ishin, çfarë përmbanin në këtë dosje? Në këtë pikë po
9 shihni dosjet, po shkruani dëshminë tuaj me zotin Fatos
10 Klinaku, Nasim Haradinaj dhe anëtarë të tjerë të komitetit të
11 OVL UÇK-së apo ajo?

12 Pë. Nëse ka mundësi veç edhe njëherë pyetjen se s'e kam dëgju
13 krejt pyetjen, nëse ka mundësi?

14 Py. Në 7 shtator kur morët këtë dosje, këto dokumentet i patë
15 bashkë me Nasim Haradinajn, Faton Klinakun dhe anëtarë të
16 tjerë të OVL UÇK-së, të komitetit pra, a është kështu?

17 Pë. Shumë e saktë.

18 Py. A është e vërtetë që i vendosët këto katër dosjet mbi
19 tavolinë në zyrën tuaj?

20 Pë. Shumë e saktë.

21 Py. Dhe verifikuat se këto katër kopje ishin identike me
22 njëra-tjetrën apo jo?

23 Pë. Ne gjithë atë dokumentacionin s'e kemi verifiku prej
24 fillimit deri në fund. Aty sipër ça kanë qenë po. Kanë qenë të
25 njëjta, gjithmonë po them ato dokumentacione që kanë qenë

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 20

1 sipër tyre, 10 faqet e para apo 20 faqet e para kanë qenë të
2 njëjta. Ne nuk i kemi kontrollu prej naltit deri poshtë, vetëm
3 për sipërfaqe. Po, shumë e vërtetë kjo.

4 Py. Dhe për të verifikuar se këto faqe ishin të njëjtat, si e
5 bëtë, çfarë bëtë, çfarë patë ju në këto faqe?

6 Pë. Lexuam, pamë dokumente të njëjta, pamë që janë të
7 Gjykatës Speciale, pamë që janë të gjykatës serbe kështu. Ka
8 qenë dhe më shumë, nuk i kemi analizuar se ish koha shumë e
9 shkurtër për shkak që kishim ftuar mediat. Po përgatiteshim
10 për konferencë.

11 Py. Dhe për t'i krahasuar këto faqet, cilat pjesë të këtyre
12 faqeve, cilët elementë të këtyre faqeve patë ju për të dalë në
13 përfundimin se këto faqe ishin identike me njëra-tjetrën?

14 Pë. Unë thashë elemente s'kemi mujt të bëjmë ne se ne s'jemi
15 eksperta të dokumentacioneve, të këqyrim a janë origjinale,
16 apo janë fallco apo janë... Po ne pamë mbishkrimi ishte i
17 njëjtë, teksti ishte i njëjtë, numrat ishin të njëjtë dhe kjo
18 ka qenë diçka tjetër, nuk janë bërë ekspertiza për
19 dokumentacionin ne.

20 Py. Ju patë faktin se numrat ishin të njëjtë. Cilat numra
21 përmendni, për cilat numra flisni? Për numrat e çështjeve që
22 janë në këto faqe?

23 Pë. Real se s'jam jurist edhe s'jam prokuror as gjyqtar që
24 t'i di ato numrat që ti flas me numra rendorë se ne numrat
25 s'më kujtohen çfarë numra kanë patur, po e di që kanë pasë

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 21

1 faqet e njëjta, kështu që për numrat rendorë këtu nuk e di,
2 apo numër pesë a gjashtë a shtatë po ka qenë e njëjtë, faqja
3 ka qenë e njëjtë, mbishkrimi ka qenë i njëjtë, këto di të
4 garantoj. Për tjetër jo nuk mujt të thom se s'jam ekspert i
5 asaj lëmie që ta verifikoj, ta di substancën e sajna.

6 Py. Zoti Gucati, ndërkohë që po shihni këto dokumente, e
7 kuptuat se këto dokumente përmbanin emra dhe deklaratat të
8 dëshmitarëve apo jo?

9 Pë. Jo, unë e kam pa ma shumë mbishkrimet që ka pasë
10 deklaratat, po emrat e dëshmitarëve s'i kam lexuar se i kam pa
11 dëshmitarët. Më së pari kam pa dëshmitarët serbë, ata që kanë
12 qenë që e kemi diskutuar edhe më herët, që s'lejohej të
13 përmenden emrat. Po kam pa emrat e dëshmitarëve serbë ma
14 shumë, në faqet e para kam pa deklaratat e tyre.

15 Py. Çfarë nënkuptoni kur thatë "deklaratat e tyre në faqen e
16 parë"? Deklaratat e kujt?

17 Pë. Deklaratat e dëshmitarëve serbë që kanë jepur.

18 Z. REES: [Përkthim] Kjo pyetje a nuk kërkon emrat?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Atëherë
20 duhet ta riformulojmë pyetjen sepse në këtë formë i kërkon një
21 emër.

22 Z. REES: [Përkthim] Më mirë të shkojmë në seancë private
23 që ta lejojmë dëshmitarin të përgjigjet lirshëm.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Jo, do
25 riformulojmë pyetjen.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 22

1 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mirë.

2 Py. A patë deklaratat të dëshmitarëve serbë zoti Gucati?

3 Pë. Në ato dokumentacione çka kam pa njëherë, kam pa deklaratat
4 të dëshmitarëve serbë kam pa që keni marrë udhëzime nga
5 [REDAKTUAR] nga Vukçeviçi, këto ka qenë deklaratat e atyre
6 prokurorëve serbë që keni marrë ju, kështu kanë qenë. Dhe kanë
7 qenë disa takime që ish-prokurori i Gjykatës Speciale
8 Williamson nëse s'gaboju apo një tjetër tash emri s'po më
9 kujtohet për momentin që e kanë pasë takimin me prokurorët
10 serbë, kështu kanë qenë disa deklaratat të tyre që kanë qenë
11 këto kam pa.

12 Py. Dhe a i verifikuat ju nëse kishte emra të dëshmitarëve të
13 etnive të ndryshme si për shembull, serbë, turq, romë dhe
14 dëshmitarë shqiptarë?

15 Pë. Unë thashë edhe pak më herët, nuk jam ekspert i asaj
16 lëmie që unë bëj verifikime dhe të konstatoj dokumentacionin
17 në është i vërtetë apo është fallcë. Kështu që unë e kam pa,
18 kam thënë edhe dje, unë s'jam hakmarrës ndaj asnjë dëshmitari,
19 asnjë njeriu, kështu që as në televizione, as në media publike
20 unë s'kam përmend emra të dëshmitarëve. Kështu që unë ato çka
21 kam pa po i thom, po i tregoj në prezencën e juve.

22 Py. Pyetja ime ishte ndryshe. A patë ju në dokumente se
23 kishte emra dhe deklaratat nga dëshmitarë që vinin, që kishin
24 etnitete të ndryshme, si për shembull, dëshmitarë serbë, turq,
25 romë dhe shqiptarë? A e patë apo s'e patë?

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 23

1 Pë. Mu më shumë më kanë interesu deklaratat që kanë lyp për
2 Adem Jasharin, që kanë bërë një deklaratë aty më ka befasu.
3 Kam pa ksi deklaratë, s'më ka interesu shumë deklaratë e
4 dëshmitarit, që e kam ditë ata dëshmitarë 99 përqind që kanë
5 gënju dhe kanë rrejt kështu që s'jam marrë shumë me ata
6 dëshmitarë. Ka pasë serbë, turq, romë gjithë etnitë kështu që
7 s'më hyjnë fare në punë deklaratat e tyre.

8 Py. Patë, e patë se kishte deklaratë nga dëshmitarë serbë,
9 turq, romë edhe shqiptarë apo jo, i patë?

10 Pë. Unë shqiptarët nuk e ceka më së pari, po thashë kam parë
11 deklaratë të etnive të ndryshme, kështu që s'më kanë hy në
12 punë fare ato deklaratat e tyre, po të më hyjshin në punë
13 s'kisha frikë që ta lexoj një deklaratë në publik dhe të
14 thojsha që kjo deklaratë shkrun kështu kështu. Asnjë deklaratë
15 s'e kam përmend nëpër media as në televizione.

16 Py. Pyetja është, a i patë këto emra dhe deklaratë të
17 dëshmitarëve, a i patë zoti Gucati?

18 Z. REES: [Përkthim] Cilët emra?

19 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

20 Py. Emrat e dëshmitarëve serbë, romë, turq dhe shqiptarë. A i
21 vutë re deklaratat e dëshmitarëve serbë, romë, turq dhe
22 shqiptarë në këto dokumente?

23 Pë. Unë thashë gjuhën angleze s'e njof fare. Aty ka pasë
24 deklaratë në gjuhën angleze dhe në gjuhën serbe, kështu që
25 asnjë deklaratë s'kam qenë i interesum të lexoj, po ju them me

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 24

1 singeritetin ma të madh. Po t'i kisha lexuar, tash kisha kërku
2 seancë private dhe do të kisha thënë pa kurrfarë problemi, pa
3 kurrfarë frike, kam lexu dhe të kisha tregu tekstin e tyre, po
4 nuk i kam lexu asnjë deklaratë që s'më kanë hy në punë
5 deklaratat e tyre. Thashë mu më ka interesuar krejt ka qenë
6 interesimi im dhe i Organizatës së Veteranëve të Luftës se
7 Gjykata Speciale bashkëpunon me Gjykatën serbe me Prokurorinë
8 serbe, me Vukçeviçin dhe [REDAKTUAR].

9 Këto të tjerat, ata janë dëshmitarë shumë të vogël për
10 hesapin tim. Ata as që merrem me ta, as nuk e kam ndërmend të
11 merrem me ta.

12 Py. Çfarë është një "dëshmitar i vogël" zoti Gucati?

13 Pë. Unë të thashë edhe njëherë unë as që merrena, as që duhet
14 të merrena me ta, as më intereson puna e tyre thashë edhe më
15 herët. Po të më kishte interesu të jemi të singertë që tash do
16 të kisha kërku seancë private dhe do t'ju kisha thënë me emër
17 mbiemër. Po të jeni të bindur se përjashtim iksit apo
18 ipsilonit t'i dëgjosh me emër, atyne i njef krejt populli që
19 s'po di qysh t'ia ngjis një pseudonim atij njeriu, ato. Të
20 tjerët nuk i di unë, po të them singerisht, po të di diçka do
21 të kisha kërkuar seancë private dhe do të kisha fol haptas, pa
22 problem hiç fare, se kom problem atë punë.

23 Py. Pra krahas faktit që nuk ishit të interesuar në këta
24 dëshmitarë të vegjël, ju e patë se kishte deklarata nga
25 dëshmitarë të tjerë në këto dokumente. A është e saktë, a

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 25

1 është kështu?

2 Pë. Jo, nuk është e saktë, se unë s'thashë kam pa, as kam
3 lexu. Unë thashë mu më ka interesuar vetëm deklaratat e
4 Prokurorisë serbe që ka montuar dhe ka bo gënjeshtër të
5 mëdhaja kjo më ka interesu mu, të Vukçeviçit. Këto të tjerat,
6 që s'jam merr me, thashë me dëshmitarë të tjerë. Thashë as unë
7 as shokët e mi s'janë merrun, jo që du ta mbroj dikënd në këtë
8 aspekt.

9 Py. Do të doja t'ju tregoja zoti Gucati transkriptin e
10 intervistës që keni bërë më 7 shtator në programin "Imazh",
11 programin televiziv "Imazh".

12 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dhe është prova P0009-80 98, pra
13 P000980 dhe 80 [sipas përkthimit]. Në versionin në anglisht
14 është faqja 7, rreshti i parë. Për versionin shqip është faqja
15 7, nëse mund ta vendosim në ekran ju lutem.

16 Z. REES: [Përkthim] Mund të na jepni dhe datën ju lutem
17 dhe orën?

18 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Është intervista e 7 shtatorit,
19 emisioni televiziv "Imazh".

20 Py. Z. Gucati, a mund t'i hidhni një sy rreshtit 7 dhe më
21 poshtë të faqes 7 të transkriptit të intervistës që keni para
22 jush? Keni thënë gjatë kësaj interviste se:

23 "Ka një gamë të madhe njerëz atje, ka serbë, ka romë, ka
24 turq".

25 A e pranoni se e keni thënë këtë?

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 26

1 Py. Kështu para 15 minuta, 10 minuta që ka serbë, ka romë e
2 turq, këtë e thashë edhe para 5 minutash që në këtë seancë e
3 thashë.

4 Pë. Ju pyetën:

5 "A ka, a janë këto dosje çfarë keni parë emra
6 dëshmitarësh përmbajtje intervistash"?

7 Po i referohem fjalisë tjetër. Dhe ju jeni përgjigjur:

8 "Këta emra dëshmitarësh dhe intervistime..."

9 A e pranoni se e dinit se kishte emra dëshmitarësh dhe
10 intervista në dokumentet që morët më 7 shtator?

11 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Për Sekretaren e Gjyqit, ju lutem
12 nëse transmetohet, nëse po transmetohet, ju lutem vendosni
13 versionin e redaktuar në ekran ju lutem. Faqen 7.

14 Py. Pra zoti Gucati në lidhje me përgjigjet që ju keni dhënë
15 kur keni deklaruar se ka emra dëshmitarësh dhe intervistime,
16 pra a pajtoheni se kur keni parë dokumentet ju keni kuptuar se
17 kishte deklarata dëshmitarësh dhe intervista në paketat e
18 dokumenteve që ndatë me shtypin më 7 shtator, 2020?

19 Pë. Është shumë reale që unë e kam thënë, kam pa dhe kam pa
20 dhe ditë, se këtu përmenden edhe ditë edhe në gjuhën serbe
21 edhe në gjuhën shqipe, e enjte, e premte apo e mërkurë që janë
22 këtu fort mirë shifen. Po kur më ka pyetur:

23 "A ke pa emra shqiptarë"?

24 Kam thënë, jo. Ja ku e ke në rreshtin 21 dhe 22 që më pyet mu:

25 "A ke edhe emra shqiptarë"?

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 27

1 Unë kam thënë, jo dhe shtu nuk mund ta mbaj që të them
2 s'kam bo deklarata, unë e thashë edhe më herët. Kam pa po s'më
3 kanë interesu fare hiç. Thashë që s'më kanë interesu fare
4 deklaratat e këtyre gënjeshtarëve, kjo është arsyeja pse e kam
5 thënë kështu edhe po them edhe prapë.

6 Py. Më vonë, më pas në të njëjtën intervistë ju pyetën, iu
7 referuat intervistave specifike, intervistimeve specifike dhe
8 thatë: [sipas përkthimit]

9 "A janë, dëshmitarët serbë në këtu dhe aty që përmenden"?

10 Dhe ju thatë:

11 "Jo, shqiptarë".

12 A pajtoheni që e keni parë se kishte dhe dëshmitarë që
13 intervista të dëshmitarëve shqiptarë pra në paketën e
14 dokumenteve që ndatë në konferencën për shtyp më 7 shtator,
15 2020?

16 Pë. Jo, unë nuk e di qysh e kupton ti, "jo shqiptarë". Unë
17 kam thënë, jo atë ditë s'kam pa në ato fletë që e kam pasun në
18 dorë. Është reale që s'kam pa dëshmitarë shqiptarë, kështu
19 edhe kam thënë: "Jo, shqiptarë". Kjo është shumë reale. E këtu
20 nuk e di qysh e kuptoni tekstin e kësajna, është shumë mirë,
21 "jo shqiptarë". Unë kam thënë dëshmitarët janë serbë. Dhe aty
22 që mu më ka pyetur a ka shqiptarë? Unë kam thënë jo,
23 shqiptarë. Shumë mirë është prezantuesi ku pyetur, mund ta
24 lexoni. E keni në rreshtin 21.

25 Py. Z. Gucati, juve ju pyetën në lidhje me këtë intervistën

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 28

1 specifike të cilës ju referuat nëse dëshmitarët ishin serbë,
2 për këtë dhe këtë tjetrën. Për këtë intervistë dhe intervistën
3 tjetër që përmendët ju. Dhe ju u përgjigjët:

4 "Jo, shqiptarë".

5 A nuk po thonit kështu se dëshmitari nuk ishte serb por
6 në fakt shqiptar?

7 Pë. Jo, nuk ishte shqiptarë, jo, të lutem. Jo, shqiptarë. Se
8 duhet me thënë "Po, shqiptarë" i bien po, jo i bien nuk është.
9 Kjo është fjala, teksti në gjuhën shqipe, "jo shqiptarë". Nëse
10 them po, shqiptarë i bien që po, është e vërtetë. Po unë po
11 them "jo shqiptarë". Atëherë ju lutem mos ma ngatërroni se
12 gjuhën shqipe të paktën e di shumë mirë se jam shqiptar, babë
13 edhe nonë i kam shqiptarë, kam lind shqiptar. Jo shqiptarë.
14 Thirreni gjuhëtarë të gjuhës shqipe dhe mund t'ja u përkruajn
15 këtë fjalinë time shumë mirë.

16 Py. Pra ju po sugjeroni për pyetjen, "A ishte dëshmitari
17 serb"? Ju u përgjigjët "Jo, shqiptar" për të nënkuptuar se jo,
18 nuk ishin dëshmitarë shqiptarë këtë po thoni?

19 Pë. Po, këtë po them, s'ka qenë dëshmitar shqiptar po ka qenë
20 serb. Atë deklaratë që kam lexu unë, kam thënë "jo, shqiptar,
21 po serb", kjo është reale. Kështu kam thënë unë e kështu është
22 në kontekst nuk muj e nxjerri ndryshe këtë fjali "jo,
23 shqiptar". Po të kisha thënë po, kisha thënë po, shqiptar, po
24 se kam përmend fjalën po, më vjen shumë keq, fjalën po s'e kam
25 përmend.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 29

1 Py. Z. Gucati do të doja të tregoja në të njëjtën intervistë,
2 faqen 6 të këtij transkripti. I referohem fjalisë -- një
3 moment ju lutem. I referohem fjalisë ku ju pyetën:

4 "Cila është përmbajtja e tyre"?

5 E këtyre dosjeve. Dhe ju jeni përgjigjur:

6 "Siç kemi thënë gjithmonë Gjykata e Specializuar
7 bashkëpunon me prokurorinë serbe dhe po merr deklaratat në
8 Serbi dhe bashkëpunon me dëshmitarët të ashtuquajtur
9 "shqipfolës", të cilët kanë qenë në anën serbe. Pra Gjykata po
10 punon me shqipfolës, me ata që nuk kanë interesin më të lartë
11 në mendje të këtij vendi dhe të UÇK-së".

12 A nuk po i referoheni ju këtu zoti Gucati dëshmitarëve
13 shqiptarë, për të vënë në diskutim besnikërinë e këtyre
14 dëshmitarëve ju i referoheni si "shqipfolës"?

15 Pë. A mujt me folë?

16 Py. A po i referoheni dëshmitarëve shqiptarë dhe po përdorni
17 termin "shqipfolës" në mënyrë që të hidhni dyshime mbi
18 besnikërinë ndaj vendit dhe ndaj UÇK-së?

19 Pë. Është shumë e vërtetë që e kam thënë këtë deklaratë s'e
20 mohoj dhe mujt ta argumentoj këtë punë. Unë gjithmonë kam pasë
21 mendimin dhe fjalën te ata shqiptarë shqipfolës siç [REDAKTUAR]
22 [REDAKTUAR] dhe kjo është e vërtetë që
23 nuk mujt ta mohoj unë, që atij njeriu s'mujt t'i them ka qenë
24 kombëtar, ka luftu për vendin e vet, e ka dash vendin e vet
25 dhe kjo gjithmonë i referohena [REDAKTUAR].

1 Po në vendin tonë të ishte një njeri që bashkëpunon me
2 armikun e vendit tonë, unë besoj që edhe ti do ta qujshe
3 shqipfolës apo tradhtar të vendit. Kështu që unë nuk e mohoj,
4 gjithmonë ka qenë fjala te personi në fjalë që e përmendëm më
5 herët, kjo është reale.

6 Kështu që unë s'mujt t'i them një njeriu që ka bo masakra
7 në Gjakovë, masakra që ka përdhunu 20 mijë vajzat tona, nënat
8 tona, apo gratë tona, apo motrat tona, kështu që ka qenë shumë
9 reale. I jam referu personit në fjalë gjithmonë. Kjo është
10 edhe dëshmi me të gjitha dokumentacionet që dihet, e gjithë
11 opinionit shqiptar e njef kush është ai person. Kjo ka qenë që
12 i jam referuar në këtë fjalor këtu që, në televizionin Imazh,
13 në televizionin publik të Kosovës.

14 Py. Z. Gucati, në momentin kur dhatë dokumentet, ata
15 personave që merrnin pjesë në konferencën për shtyp më datën 7
16 shtator, ju donit që të gjithë ta merrnin vesh që kishte
17 deklarata dëshmitarësh në këto paketa apo jo?

18 Pë. Jo, s'është e vërtetë. Ne kemi dashtë t'i tregojmë
19 opinionit të gjerë të Kosovës po ashtu edhe miqve tanë
20 ndërkombëtarë, t'ju tregojmë që Organizata e Veteranëve të
21 Luftës ka të paktën të drejtë pse e kundërshton Gjykatën
22 Speciale. Arsyëja ka qenë kjo, që Gjykata Speciale e cila
23 është votuar nga Parlamenti i Kosovës, nga deputetët tanë që e
24 kanë marrë votën prej popullit të Kosovës dhe kjo Gjykatë
25 Speciale duhet të jetë e Kosovës dhe jo bashkëpunon me një

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 31

1 gjykatë serbe. Kjo ka qenë arsyeja pse ne kemi dashtë ta bëjmë
2 publike.

3 Ne e kemi ditë që ka dëshmitarë dhe s'na ka interesuar që
4 20 vite edhe sot s'na intereson kush është dëshmitar fare. Kjo
5 nuk është që ne e kemi shpik ujt e nxehtë sot, po ne e kemi
6 ditë, ka dëshmitarë prej të gjitha kombësive dhe kështu ne
7 s'na ka interesuar fare ajo punë. Ne na ka interesuar vetëm
8 pse Gjykata Speciale bashkëpunon me Gjykatën serbe tuj e ditë
9 që gjykata serbe është armike e vendit tim dhe e shokëve të
10 mi, kjo është arsyeja. Për këtë arsye, ne e kemi bo publike
11 dhe e kemi thënë.

12 Py. Dhe ju i përcollët publikut gjatë konferencës për shtyp
13 se dokumentet që po vendosni në dispozicion tek ata që ishin
14 të pranishëm përmbanin deklarata për shtyp, emra dhe
15 intervista apo jo?

16 Pë. Asnjë mediumi s'i kam thënë, që merri këto dokumenta dhe
17 shiqoji a ka dëshmitarë a s'ka apo ka deklarata. Asnjë
18 televizioni, asnjë portali në Kosovë. Kjo që është shumë e
19 vërtetë. Unë e kam thënë këto janë dokumentacione të Gjykatës
20 Speciale që e ka një emblemë, ka një vulë dhe dihen që janë të
21 Gjykatës Speciale dhe ja kam thënë është reale që Gjykata
22 Speciale bashkëpunon me Vladimir Vukçeviçin dhe me disa
23 persona të tjerë në Serbi. Kjo është reale. Qëllimi im ka qenë
24 kjo, t'ju tregojmë opinionit.

25 Py. Gjatë konferencës së parë për shtyp, a e vutë në dijeni

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 32

1 publikun se dokumentet që po ndanit përmbanin intervista të
2 dëshmitarëve, po apo jo?

3 Pë. E nderume zonzjë, unë po të them, ne e kemi deklaruar dhe
4 kemi thënë, në konferencën e parë edhe të dytë edhe të tretë,
5 këto dokumentacione rrjedhin nga Gjykata Speciale dhe
6 bashkëpunon me gjykatën serbe. Është e vërtetë kur gazetari na
7 ka pyet, ne i kemi thënë gazetarëve, "ka emra të dëshmitarëve,
8 ka deklarata". Po këto janë të ndalume me ligj se privatësia e
9 çdo qytetari në Kosovë edhe në botë ruhet. Është shumë reale
10 që e kemi thënë, "ka deklarata edhe dëshmitarë", po privatësia
11 e çdo individi ruhet. Secili e merr barrën për vete nëse bën
12 në publik një emër të një dëshmitari, kjo ka qenë. Dhe prapë
13 qëndroj prapa sajna.

14 Py. Gjatë kësaj konference për shtyp, a thatë se dokumentet
15 që po ndanit me ata që po merrnin pjesë përfshinin deklarata
16 dhe intervista të dëshmitarëve? A e keni thënë apo jo?

17 Pë. Nëse më keni kuptu dhe nëse e ka përkthyer shumë mirë,
18 unë e thashë, ne ju kemi thënë mediave në bisedë e sipër, apo
19 në konferencë e sipër që na ka pyetur gazetari, a ka emra të
20 dëshmitarëve dhe deklarata? Ne i kemi thënë, ka emra dhe ka
21 deklarata, janë të ndalume, privatësia e çdo qytetari ruhet.
22 Nuk keni të drejtë të bëni publik asnjë emër edhe asnjë
23 deklaratë, kjo ka qenë e vërteta. Nuk e di ma mirë qysh do të
24 përgjigjem unë apo më thjesht.

25 Py. Faleminderit. Në lidhje me paketën e dytë të dokumenteve,

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 33

1 të cilat jua shpërndatë atyre që merrnin pjesë në konferencën
2 e dytë për shtyp. A e dinit ju zoti Gucati që këto materiale
3 përmbanin po kështu komunikim midis TFHS-së dhe autoriteteve
4 serbe ekzaktësisht si paketa e parë kështu është?
5 Pë. Real ma s'më ka interesu paketa e dytë ose e treta po dhe
6 e katërta me pasë ardhë apo e gjashta paketë me ardhë mu s'më
7 kishte interesu të lexoj diçka. Interesimi jem ka qenë paketa
8 e parë. Interesimi jem ka qenë kur personi në fjalë, hetuesi
9 juaj që e ka pranuar që këto dokumentacione janë të juvet dhe
10 më mu nuk më ka interesuar të lexoj deklaratat e askujt.
11 Qëllimi im ka qenë që gjithmonë t'i tregoj opinionit të gjerë
12 dhe miqve tanë ndërkombëtarë që na dojnë të mirën e vendit
13 tonë, që na kanë ndihmuar për çlirimin, që kjo Gjykatë
14 bashkëpunon me kriminelët serbë. Kjo ka qenë, edhe më mu -
15 edhe 50 paketa të ishin ardhur, unë më nuk do të isha merr me
16 deklaratat e tyre. Të jeni të bindur që asnjë deklaratë me e
17 lexu s'e kam, se s'më ka hy në punë, po them singërisht, se
18 gjithë opinionit i Kosovës e din që ju i keni bo ftesat, kanë
19 ardhur kanë jep dëshmi këtu. S'ka kurrëgjë të keqe pse kanë
20 ardhur kanë jep dëshmi, veç ishalla kanë japë dëshmi të
21 vërtetë, s'kanë rrejt. Kjo është me rëndësi.
22 Py. Faleminderit për përgjigjen zoti Gucati, po nuk ishte
23 përgjigje për pyetjen time. Pyetja ime është kjo. Kur i patë
24 paketën e dytë, dokumentet e paketës së dytë që iu dha OVL
25 UÇK-së, a e vutë re që mes këtyre materialeve kishte dhe

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 34

1 komunikim midis TFHS-së dhe autoriteteve serbe ekzaktësisht si
2 në paketën e parë? A është kështu siç po them unë?
3 Pë. Unë po të them, ti po e bon pyetjen shumë ndoshta mirë,
4 ndoshta s'jam tu e kuptu unë në theks krejt pyetjen. Unë po të
5 them me sinjeritetin më të madh, nuk më ka interesu thashë. Mu
6 më ka interesu paketa e parë dhe jam bind që jeni duke
7 bashkëpunuar me gjykatën serbe, kjo ka qenë gjithçka. Është
8 shumë reale që prapë edhe në paketën e dytë ka pasë
9 dokumentacione që keni bashkëpunu me gjykatën serbe, kjo
10 mu...Ndoshta, po më vjen shumë keq, s'po di me tu përgjigj
11 krejt bukfalisht po kjo është çka po të them unë. Nuk më ka
12 interesu ma shumë. Edhe 60 paketa të vijshin, mund interesimi
13 im s'ka qenë të hulumtoj aty çka ka brenda. Se është vërtetu me
14 paketën e parë, e keni vërtetu me paketën e dytë që janë
15 dokumentet e juve, që mos ishin dokumentacioni, ju mu s'më
16 kishit shti në burg sot, unë s'isha këtu para juve. Nëse
17 s'janë konë të juvet, pse më kini marrë në burg ju mu? Unë po
18 them prapë, dokumentacioni ka rrjedh nga ju. Bashkëpunimi ka
19 qenë shumë i ngushtë, ku e keni falënderuar gjykatën serbe, [e
20 pakuptueshme] që David tash që thotë, "E falënderoj Gjykatën
21 Speciale të Serbisë për bashkëpunimin", dhe këto mu. Kjo është
22 reale. Unë këtu s'muj ta mshefi e të thom që s'e kam pa, s'e
23 kam lexu me sytë e mi. Ma ka përkthi zotnia dhe kjo është e
24 vërtetë.
25 Py. Z. Gucati, ju falënderoj për përgjigjen, po këtej e tutje

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 35

1 ju lutem dëgjojeni me kujdes pyetjen dhe përpiquni t'i
2 përgjigjeni pyetjes në fjalë. Pra e kuptova saktë që e dinit
3 asokohe, në konferencën e dytë për shtyp që paketa e dytë
4 përmbante komunikime midis TFHS-së dhe autoriteteve serbe,
5 ekzaktësisht si paketa e parë? Është kështu apo jo? Ju lutem
6 një përgjigje "po" ose "jo".

7 Pë. Unë më shumë nuk di çka me t'u përgjigj se që ato që
8 thashë më herët, më fal. Kërkoj falje, ajo është përgjigjja
9 ime që dhashë më herët. Kërkoj ndjesë, kështu që s'kam çka të
10 përgjigjem më shumë.

11 Py. Përgjigjja është "po" apo "jo"?

12 Pë. Nëse më kupton shumë thjesht, unë thashë përgjigje nuk
13 kam.

14 Py. Z. Gucati, nuk u përgjigjët. Po ju pyes, a e dinit apo
15 nuk e dinit që paketa e dytë e dokumenteve përmbante
16 komunikime midis TFHS-së dhe autoriteteve serbe. Ju lutem
17 përgjigjuni ose me "po" ose me "jo", pa shpjegime të
18 hollësishme. "Po" ose "Jo".

19 Pë. Të njëjtë si paketa e parë, paketa e dytë, paketa e tretë
20 keni qenë në bashkëpunim me gjykatën serbe. Nuk di qysh të
21 përgjigjem më shumë.

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mundeni që
23 t'i kërkonit dëshmitarit që të përgjigjet shkurt?

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Gucati,
25 ju ka kërkuar të përgjigjeni me "po" ose me "jo" ose...

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 36

1 Një moment, një moment zoti Rees.

2 Ose mund të thoni "nuk e di". Por nuk mund të jepni një
3 përgjigje që nuk përmend as "po" as "jo".

4 Z. Rees tani e keni fjalën.

5 Ishte një pyetje shumë e drejtpërdrejtë.

6 Z. REES: [Përkthim] "Po", "jo" ose "nuk e di".

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po, po në
8 rregull, mund të thotë pra, "po", "jo" ose "nuk e di". Pra ose
9 "po", "jo" ose "nuk e di".

10 I AKUZUARI GUCATI: I nderum, unë s'jam tu i ik pyetjes as
11 përgjegjesisë se s'e kam frikë atë punë thashë edhe më herët.
12 Unë e tregova nëse don Prokurorja të nxjerrë mes rreshtave ça
13 i kam thënë, e ka përgjigjen aty. Unë i tregova më herët, si
14 paketa e parë, si paketa e dytë, si e treta, të gjitha janë në
15 bashkëpunim me Serbinë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Gucati,
17 "po", "jo", "nuk e di", cila nga këto?

18 I AKUZUARI GUCATI: I nderum, po më vjen shumë keq, unë
19 përgjigjen jam tu e kthy shumë mirë, përkthyesi besoj se është
20 tu ja u përkthy dhe ju qysh po thom unë. Ça kam pa në paketën
21 e parë që ka bashkëpunuar me Serbinë ka qenë edhe në paketën e
22 dytë kjo është reale.

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Atëherë po e marr si "po".

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 37

1 Py. Krahas dokumenteve që kishin të bënin me komunikime midis
2 TFHS-së dhe autoriteteve serbe, a vutë re ndonjë lloj tjetër
3 dokumenti në paketën e dytë zoti Gucati?

4 Pë. Jo, sinqerisht, jo, se s'kam kontrolluar, thashë, s'kam
5 qenë më i interesum t'i këqyr ato paketat fare. Jo s'kam
6 kontrolluar paketat. Të them me sinqeritetin më të madh, s'kam
7 kontrolluar. Aty i kanë vënë mediat shumicën e tyre kur kemi
8 ba ne konferencën atë ditë dhe e kam marrë unë. As unë as
9 shokët e mi s'besoj. Unë për vete jo, nuk i kam marr të
10 kontrolloj as faqen e parë, as të dytën se s'më ka hy në punë
11 thashë edhe më herët. Me sinqeritetin më të madh flas. Nuk e
12 kam këqyr përmbajtjen e tyre s'e kam këqyr, të jeni të bindur.

13 Py. Gjatë pyetjeve që jua bëri avokati juaj, zoti Gucati
14 thatë, i thatë avokatit se kishit vënë re se kishte dokumente
15 që kishin të bënin me gjykimin e Limajt në TPNJ, kështu është,
16 e pranoni këtë?

17 Pë. Atë e kam thënë edhe sot si thashë që ka pasë
18 dokumentacione nga Gjykata Speciale për Krimet e Jugosllavisë
19 të Limajt dhe të Ramush Haradinajt. Thashë edhe sot, edhe dje
20 e kam thënë. Po në cilën paketë e kam pa nuk e di. Të jem i
21 sinqertë, unë thashë atë e kam pranë edhe dje edhe sot. Kam pa
22 aty dokumentacione të Fatmir Limajt dhe të Ramush Haradinajt,
23 po kam pa aty dokumentacione por në cilën paketë saktë, mund
24 të gënjej tash them a në të dytë, apo në të tretën nuk gënjej
25 që mos të dal kështu gënjeshtar para juve.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 38

1 Py. Dhe gjatë konferencën së dytë për shtyp zoti Gucati,
2 vendosët që t'i tregonit shtypit pikërisht disa prej
3 komunikimeve midis TFHS-së dhe autoriteteve serbe nga të
4 gjitha dokumentet që kishit përpara, kështu është?

5 Pë. Ne aty i kemi gjetë në tavolinë, në konferencë dhe kemi
6 tregu që këto dokumentacione rrjedhin nga Gjykata Speciale dhe
7 janë dokumente që kanë bashkëpunuar, kështu e kemi thënë, po.

8 Py. Dhe e tërhoqët vëmendjen e shtypit gjatë konferencës së
9 dytë për shtyp ndaj komunikimeve midis TFHS-së dhe ZPS-së, ju
10 kujtohet kjo?

11 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo konferencë
12 për shtyp është e regjistruar, është e incizuar plotësisht dhe
13 e kemi incizimin edhe zbardhjen në tekst. Unë parashtroj se
14 është e padrejtë që t'i vazhdojmë t'i bëjmë pyetje zotit
15 Gucati nëse i kujtohet e çfarë kujtohet nga këto tri
16 konferenca që janë në shtator të vitit që shkoi. Ndërkohë që
17 ne e dimë me saktësi se ç'u ka thënë e ç'nuk ka thënë dhe që
18 është e incizuar.

19 Nëse ka ndonjë pjesë të veçantë të këtij incizimi që
20 zonja Bolici dëshiron t'ia thotë zoti Gucati, ajo mund ta
21 përmendë?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
23 Faleminderit zoti Rees.

24 Z. REES: [Përkthim] Ishte kundërshtim i nderuar Gjykatës.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Nuk

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 39

1 pranohet kundërshtimi.

2 Vazhdoni zonja Bolici.

3 ZNJ. BOLICI:

4 Py. Z. Gucati, në konferencën e dytë për shtyp nga ato
5 dokumente të shumta që përmbante paketa e dytë, ju vendosët që
6 atyre që ishin të pranishëm t'u tregonit disa dokumente që
7 kishin të bënin me bashkëpunimin midis TFHS-së dhe
8 autoriteteve të prokurorisë serbe, më falni, të prokurorisë
9 serbe, kështu është?

10 Pë. Më falni, çdo send që e kam thënë është në incizim, është
11 mirë të bëhet publike nëse e keni CD-në ta lëshoni dhe ta
12 shikoni çdo send çka kam folur në video.

13 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj që dëshmitarit t'i
14 tregojmë provën me numër P0002, që është një video e
15 konferencës së dytë për shtyp. Pjesa përkatëse, domethënë vula
16 kohore është duke filluar në minutën 00:00:50 deri në
17 00:01:06. Kjo përkon me, pra përkon me tekstin e zbardhur në
18 anglisht P00002-ET. Është paragrafi i dytë dhe i tretë. Dhe
19 është provë materiale konfidenciale.

20 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja
22 Bolici jemi në seancë publike. Po të lëshohet kjo video, do të
23 dalë zëri por jo pamja.

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kjo pjesë në veçanti nuk përmban
25 asgjë konfidenciale për sa kohë që video mund të ndalojë në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 40

1 00:01:06 nëse ndalon aty. Kur të arrijmë në atë vulë kohore,
2 pra deri në atë moment s'ka asgjë konfidenciale.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja
4 Sekretare në rregull është?

5 Mirë në rregull, mund të vazhdojmë.

6 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Pra nga numri 00:00:50 deri në
7 00:01:06.

8 [Luhet videoincizimi]

9 VIDEOINCIZIMI: "Pra vetëm dy-tri fletë qysh po jua tregoj
10 juve që i kam përpara vetes që janë në gjuhën serbe që mund me
11 i pa, kemi gjuhën angleze që kanë bashkëpunu".

12 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

13 Py. Z. Gucati, jeni dakord, pra pajtoheni me mua që nga shumë
14 dokumente që kishit juve përpara gjatë kësaj konferencës së
15 dytë për shtyp, ju vendosët që t'ia tregonit, të shfaqnit
16 komunikimet midis TFHS-së dhe prokurorisë serbe si në
17 anglishte dhe në serbishte, që sipas fjalës tuaj që vërteton
18 bashkëpunimin midis këtyre dy institucioneve?

19 Pë. Është shumë e vërtetë se këto tri dokumente i kam tregu
20 unë për arsye që të bindi opinionin, që t'ju tregoj që Gjykata
21 Speciale punon dhe bashkëpunon me gjykatën serbe, këtë e kam
22 thënë disa herë. Unë s'jam tu mçef asgjë këtu, e kam thënë
23 edhe dje edhe sot. Dhe shumë është reale që këto dokumente
24 vetë tregojnë realitetin që keni bashkëpunu me gjykatën serbe,
25 unë se kam mçef këtë as dje dhe për këtë arsye jam kundër

1 Gjykatës Speciale unë.

2 Se unë s'jam kundër drejtësisë. Kurrë në jetën time s'kam
3 qenë kundër drejtësisë se ne kemi qenë të shtypur, ne s'kemi
4 pasë drejtësi, ne kemi luftuar për një drejtësi të jetë në
5 Kosovë. Edhe prapë jam adhuruesi i asaj drejtësie që të ketë
6 drejtësi gjithmonë, kjo është reale. Kam thënë Gjykata
7 Speciale bashkëpunon me gjykatën serbe, këtë kam që disa herë
8 po e përmendi prej dje. Kjo unë nuk e di çka ka të keqe. Unë
9 jam tu e pranë publikisht që këto dokumente, është reale që
10 Gjykata Speciale bashkëpunon me Gjykatën serbe.

11 Py. Z. Gucati, janë të njëjtat lloj dokumentesh që ju kishit
12 parë dhe në paketën e parë pra në paketën që ju dorëzua më
13 datë 7 shtator, kështu është?

14 Pë. Atë nuk jam i sigurt. Nuk guxoj të flas me hamendje. Nuk
15 jam i sigurt, a kanë qenë të njëjta paketa, e para dhe e dyta.
16 Nuk guxoj të flas me hamendje se të thashë që nuk i kam
17 kontrollu. Këtu kanë qenë, mbasi kanë ardhur i kam pa këtu në
18 tavolinë ku jam ulur, kjo është shumë reale, këtu më kanë ra
19 në sy dhe e kam bo publike, këtu mbasi kam para në konferencë
20 këto tri dokumente. Kjo është shumë reale, mbasi jam ul aty në
21 konferencë i kam pa këto tri dokumente. Këtë s'e mohoj. Kjo
22 është reale.

23 Py. Këto letra kanë të njëjtën formë si të letrave që ju
24 kishit parë në paketën e parë që është dorëzuar më datë 7
25 shtator kështu është?

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 42

1 Pë. Po formati i letrës, madhësia dhe gjerësia është e
2 njëjtë, vula e TFHS-së është e njëjtë, vula serbe është e
3 njëjtë, do të thotë kjo është e njëjtë vula, mbishkrimi nuk e
4 kam lexuar se nuk e njoh gjuhën angleze, thashë edhe më herët
5 s'e kam lexuar. Po formati i letrës është i njëjtë është shumë
6 reale edhe vulat janë të njëjta, po mbishkrimin mrena s'e kam
7 lexuar, nuk e di a është i njëjtë me paketën e parë, kjo
8 është.

9 Py. Dhe natyra e dokumenteve ishte mjaft e ngjashme me ato që
10 kishit parë nga paketa e parë, kështu?

11 Pë. Te ne shqiptarët natyra kuptohet a është e bardhë apo e
12 zezë apo e kaltër letra. Natyra është reale e bardhë, letra
13 është e bardhë, vulat janë të njëjta, kjo është e ngjashme,
14 mbishkrimi nuk jam i sigurt se s'e kam lexuar thashë edhe
15 njëherë.

16 Py. Faleminderit. Dokumentet që vendosët t'ia tregonit
17 mediave gjatë konferencës së dytë për shtyp, nuk kishin të
18 bënin fare me gjykimin e Limajt kështu?

19 Pë. Sinqerisht nuk jam i sigurt në këtë drejtim. Vetëm
20 qëllimi im ka qenë që të tregoj që Gjykata Speciale siç jam tu
21 e përsërit bashkëpunon me Gjykatën serbe. Kjo ka qenë qëllimi.
22 A është e Limajt apo e dikujt tjetër iks apo ipsilonit nuk e
23 kam përmend mesa di unë, mesa më kujtohet s'e besoj. Po
24 qëllimi i vetëm ka qenë që jeni duke bashkëpunuar me gjykatën
25 serbe. Kjo ka qenë.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 43

1 Py. Thatë më herët se e përmendët gjykimin e Limajt para
2 TPNJ-së kështu?

3 Pë. Kam thënë edhe dje, jo sot, po edhe dje kam thënë, kam pa
4 dokumentacione të ish-Gjykatës Speciale për Krimet e Luftës
5 gjatë Jugosllavisë. Thashë kam pa dokumentacione të Limaj dhe
6 të Ramush Haradinaj që ka pasë ato lëndë, ka pasë, po, ka
7 pasë. Ato kanë qenë të viteve 2004-2005 nëse s'gaboje apo 2007.
8 Kështu që kanë qenë të viteve të mëhershme, po është reale, i
9 kam thënë këto.

10 Py. Dhe dokumentet që po i tregonit shtypit gjatë konferencës
11 së dytë për shtyp nuk janë dokumente nga TPNJ-ja apo jo?

12 Pë. Real thashë ekspertizën s'e kam bo këto dokumente të
13 kujna janë. Mu më ka interesu se ka qenë vula dhe stema këtu e
14 Gjykatës Speciale dhe vula dhe stema e gjykatës serbe. Kjo ka
15 qenë krejt interesimi jem që të bëj opinionin me dije që ju
16 bashkëpunuat. Thashë përmbajtja e ktyne s'më ka interesuar të
17 jem i sinqertë.

18 Py. Pra shtypit po tregonit dokumente nga TFHS-ja dhe nga
19 autoritetet serbe, kështu?

20 Pë. Po është e vërtetë. Këto tri dokumentacione që janë, që i
21 kam unë këtu. Është shumë reale, shumë reale. Këtë s'e mohoj.

22 Py. Nuk e patë përmbajtjen. Nuk e kishit fare idenë nëse
23 kishin të bënë me gjykimin e Limajt apo jo?

24 Pë. Të jeni të bindur se s'e kam lexuar. Thashë gjuhën
25 angleze, s'e kuptoj gjuhën angleze se nuk di ta lexoj. Mbase

1 s'e kam mësu gjuhën angleze, unë tash s'do të thom që e di
2 gjuhën angleze kur s'e di se unë kam përkthyesen në
3 paraburgim, 24 orë e kam patur përkthyesen atje, për çdo send
4 duhet me përkthi se nuk e di. Kështu që s'e kam lexu
5 përmbajtjen se kur nuk e kupton gjuhën dhe s'e din, unë s'e
6 kam kuptu, s'e kam lexu fare hiç, të jeni të bindur. Këtë po
7 ju thom me sinqeritetin më të mirë. Kjo që do të thotë që s'e
8 kam lexu përmbajtjen. Me rëndësi është që mu më ka interesu që
9 Gjykata Speciale e Kosovës që e ka votu parlamenti im dhe
10 Gjykata serbe bashkëpunojnë. Kjo më ka interesu.

11 Py. Z. Gucati, që t'ju drejtoj tani te paragrafi 37 i
12 deklaratës tuaj, ku keni thënë se:

13 "Pashë dokumente serbe dhe shenja serbe në dokumente, por
14 këto veç se ishin publike dhe ishin në lidhje me raste të
15 vjetra lidhur me Fatmir Limajn. Pra dokumentet që ju ia
16 treguat shtypit nuk kishin të bënin me gjykimin e Fatmir
17 Limajt".

18 Z. Gucati. Mos është e pasaktë deklarata juaj, pra
19 paragrafi 37 i deklaratës suaj?

20 Pë. Unë e deklarova dhe më herët që thashë kam pa dokumenta
21 të zoti Fatmir Limaj, këtë s'e mohova unë. Mesa di kështu kam
22 thënë e kështu po them prapë. Kam pa dokumentet e zoti Fatmir
23 Limaj, kështu që s'e mohoj atë, tash të dal unë gënjeshtar të
24 them s'e kam pa kur kam thënë tërë kohën e kam pa. Kam pa
25 dokumentacionet e zoti Fatmir Limaj.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 45

1 Py. Dokumentet serbe me shenja serbe nuk kishin të bënin fare
2 me rastin e Fatmir Limaj apo jo?

3 Pë. Real s'më kujtohet tash a kanë qenë me dokumenta serbe,
4 me shenjën serbe apo me shenjën e Gjykatës Speciale të
5 atëhershme, tash mujt të gaboj këtu. Po unë e kam thënë edhe
6 qëndroj prapa saj që kam pa dokumentet e Fatmir Limajt. Po, ka
7 pasë. Në ato dokumenta ka pasë të zoti Fatmir Limaj.

8 Py. Në përgjithësi. Por dokumentet që ju ia treguat shtypit,
9 dokumentet me shenjat serbe, ju ishit në dijeni që nuk kishin
10 lidhje me rastin e Fatmir Limajt dhe nuk ishin tashmë publike-
11 siç deklaronit në paragrafin 37 të deklaratës tuaj, apo jo
12 zoti Gucati?

13 Pë. Thashë nuk më kujtohet që e kam thënë unë, kam pa. Po
14 mund të ketë dhe mund të jenë. Nëse kam thënë e lëshojmë
15 incizimin, unë e pranoj kam thënë, se do të thotë nuk jam një
16 njeri që s'e pranoj nëse e kam thënë. Dokumenta të Gjykatës
17 ndaj Fatmir Limaj kam pa, ka pasë shumë dokumentacione. Një
18 pjesë që kam pa dokumentacione të zoti Fatmir Limaj të asaj
19 kohe kur është dalë para drejtësie.

20 Py. Dhe kishte dhe dokumente serbe të cilat nuk kishin të
21 bënin me rastin e Fatmir Limajt dhe që nuk ishin tashmë
22 publike në kuadër të rastit të Fatmir Limajt, kështu është?

23 Pë. Unë mesa di unë kam thënë gjithmonë që kam parë
24 dokumentet e Fatmir Limajt dhe ato kanë qenë edhe publike dhe
25 në atë kohë dhe gjyqin e Fatmir Limaj ka qenë i hapur edhe në

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 46

1 Kosovë edhe në Gjykatën Speciale ku ka qenë në Hagë ku ka qenë
2 atëherë. Kështu që unë s'kam qejf asgjë dhe s'kam pasë të
3 tregoj ndonjë risi diçka për Fatmir Limaj. Që ajo punë që më
4 ka hy në punë fare për Fatmir Limaj, që të tregoj se ajo punë
5 veç ka përfunduar që 10 vite fill, mbi 15 vite. Kështu që nuk
6 jam i sigurt se s'më ka hy në punë të tregoj për Fatmir Limaj
7 kur i njoh unë vendimin e tijna dhe drejtësia që ka marrë një
8 verdikt shumë të mirë ndaj tijna.

9 Py. A e lexuat vendimin e rastit të Fatmir Limaj zoti Gucati?

10 Pë. Jo, s'e kam lexu se s'kam pasë nevojë ta lexoj se e kam
11 ditë kur është liru, kur është lexu vendimi i tijna. Nuk kam
12 pasë nevojë ta lexoj.

13 Py. E keni ndjekur procesin gjyqësor ne rastin e Fatmir
14 Limajt?

15 Pë. Ajo ka qenë me vite, vite të kalume. Po, kam përcjell
16 përmes televizionit se jo kështu. Se unë në atë kohë s'kisha
17 pasaportë që të vij këtu ta përcjelli. Dhe unë real e kam
18 përcjell veç përmes televizionit kështu. Jo live kështu s'e
19 kam përcjell, jo.

20 Py. Dhe asokohe e keni përcjellë procesin gjyqësor në rastin
21 e Ramush Haradinaj në TPNJ?

22 Pë. Çdo qytetar i Kosovës ka qenë i interesum t'i përcjellë
23 këto raste. Çdo veteran i UÇK-së ka qenë i interesum. Kështu
24 që kjo pyetje s'e di pse më bëhet po s'është problem. Po i kam
25 përcjell të gjitha, të gjitha seancat, tash, mos dal, s'e

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 47

1 s'kam pasë kohë se unë jam merr me punë, kam pasë fëmijën e
2 vogël në atë kohë, mu ka dashë të kujdesesha për familjen. Por
3 ndërkohë kam përcjell seancat e tyre.

4 Py. Pra e shihnit gjykimin në rastin e Ramush Haradinaj kur
5 transmetohej online apo jo?

6 Pë. Unë nuk e di ç'a më hy në punë, edhe juve edhe mu, nuk e
7 di pse po. Të jem i singërtë e kam përcjell ndërkohë. Thashë e
8 kam përcjell ndërkohë rastin e Ramush Haradinaj që na ka
9 dhimbt të gjithëve, që është vëlla i dy dëshmorëve, ka
10 kontribu shumë për vendin tonë, për kombin tonë dhe kështu që
11 ne na ka dhimbt të gjithëve, çdo njeni. Po e kemi përcjell, po
12 jo në çdo kohë, thashë se jam merr edhe me punë private të
13 miat, të jetës time, të familjes time, kështu që nuk kam pasë
14 edhe kohë ta përcjelli çdo seancë të tijna. Po ndërkohë kur
15 kisha kohë, po e kam përcjell.

16 Py. Ti kthehem tani paragrafit 37 të deklaratës suaj zoti
17 Gucati. Aty ju thoni se ka disa dokumente publike që kanë të
18 bëjnë me rastin e Fatmir Limajt dhe ju thoni që këto dokumente
19 janë veçse publike.

20 A pajtoheni me mua zoti Gucati nëse them se dokumentet që
21 ju ia keni treguar shtypit gjatë konferencës së dytë për shtyp
22 nuk kishin të bënin fare me rastin e Fatmir Limajt dhe do të
23 thotë që kjo që keni deklaruar ju këtu është e pasaktë kështu?

24 Py. Unë nuk e di si merresh me Fatmir Limaj, që s'kam pasë
25 nevojë të merrem me Fatmir Limaj. Po edhe nëse merrem nuk e di

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 48

1 ça ka të keqe diçka. Që kam thënë ka disa dokumente, këtu nuk
2 është tu shkru në tekst, po kam thënë, kam parë disa dokumente
3 me shenja serbe, por këto veç ishin publike. Kjo ka qenë
4 publike dhe seancat kanë qenë edhe publike dokumentacioni i
5 tijna kështu që nuk e di unë çka kam mujt të zbuloj diçka për
6 Fatmir Limaj që s'ka qenë kurrë gjë sekrete.

7 Dhe s'më ka interesu puna e Fatmir Limaj fare se ai ka
8 qenë me vite të kalume.

9 Py. Dokumentet që ia treguat shtypit nuk kishin të bënë fare
10 me rastin e Fatmir Limajt, "po" apo "jo"?

11 Pë. Për besë nuk më kujtohet, tash të jem i sigurtë, nuk e
12 besoj, po ndoshta mund të jenë se është që sa u bënë 16 muaj
13 që jam këtu në burg dhe mund të jetë ndoshta pak edhe harresa,
14 por nëse është e vërtetë atëherë i bëni publike, unë do ta
15 pranoj, s'e kam problem atë punë.

16 Py. Është videoja, të cilën unë sapa jua shfaqta, nuk dua t'i
17 kthehem.

18 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ky është
19 momenti i duhur për të bërë një pushim.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në rregull
21 atëherë, do të bëjmë pauzën e paradites.

22 Z. Cadman shikoj që keni ngritur dorën. Keni diçka për të
23 thënë?

24 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar
25 Gjykatës, është një pyetje lidhur me - nëse Trupi Gjykses do

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 49

1 të nxjerrë vendim sot për lejen për apelim sepse do të na
2 duhen edhe dhjetë ditët pastaj për këtë. Duam të dimë se kur
3 fillon afati dhjetë ditor.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Unë nuk
5 jua premtoj që do ta bëjmë sot, por mbase nesër mund të kemi
6 diçka.

7 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
9 Faleminderit.

10 Z. REES: [Përkthim] Dokumentet, të cilat përmenden në
11 video trajtohen në paragrafin 36 përpara paragrafit 37 të
12 deklaratës.

13 Jam dakord që ky është momenti për pauzë, por meqenëse
14 bëhen pyetje, kundërpjetje për deklaratën këto duhen bërë në
15 kontekstin e duhur.

16 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kundërpjetjet kishin të bënin me
17 paragrafin 37 të deklaratës dhe me përmbajtjen e asaj.

18 Z. REES: [Përkthim] Po, po përpara paragrafit 37 vjen
19 paragrafi 36.

20 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Avokati do të ketë mundësi që
21 juve ta përmendni këtë kur të bëni juve pyetjet plotësuese.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po, kështu
23 është e vërtetë.

24 Do të rikthehemi në orën 11.30.

25 --- Pauza fillon në orën 11.00

1 --- Seanca rifillon në orën 11.30

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonjusha
3 Bolici, mund të vazhdoni.

4 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar.

5 Py. Zoti Gucati, na thatë para pushimit se ishit në dijeni se
6 Paketa 2 e dokumenteve që u sollën në OVL UÇK më 16 shtator,
7 përmbanin korrespondencë mes TFHS-së dhe autoriteteve serbe.

8 Tani, ju ishit i pranishëm kur oficerët e ZPS-së më 17
9 shtator kërkuan dorëzimin e dokumenteve të Paketës 2; kështu
10 është?

11 Pë. Po, e saktë.

12 Py. Në kohën që i dorëzuat këto dokumente te oficerët e ZPS-
13 së më 17 shtator, ju ndërkohë, më përpara pra, i kishit
14 shpërndarë tek personat që ishin të pranishëm në konferencën e
15 dytë për shtyp shumicën e dokumenteve që kishit marrë më 16
16 shtator; a është kështu?

17 Pë. Ne, *de facto*, dokumentacione s'kena shpërnda. Po ne kemi
18 bë konferencë për media dhe e kemi pasë dokumentacionin në
19 tavolinë. Askujt si kemi thënë "merre".

20 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] I nderuar, nëse mund të kërkoj
21 ndjesë. Nuk e dëgjova. S'kisha vendosur mikrofonin, kështu që
22 nuk e dëgjova përgjigjen.

23 Py. A mund të ma përsërisni edhe njëherë ju lutem, zoti
24 Gucati, nuk e dëgjova?

25 I AKUZUARI GUCATI: Po. Pa problem.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 51

1 Ne, de facto, kemi mbajtur konferencë për mediat më 17 dhe të
2 gjitha dokumentacionet i kemi vënë mbi tavolinë dhe ne asnjë
3 gazetari s'i kemi thënë "merri". Kështu që, ne s'kemi shpërnda
4 materiale. S'i kemi thënë kërrkujt "merri"

5 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

6 Py. Dhe ata që ishin të pranishëm në konferencën e dytë për
7 shtyp a morën shumicën e dokumenteve që kishit vënë në
8 dispozicion për ta? A jeni në dije ju për këtë zoti Gucati;
9 apo jo?

10 Pë. Sa kanë marrë nuk e di. Po jam në dijeni që kanë marrë
11 disa dokumentacione. Po sa kanë marrë nuk e di.

12 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do doja t'i tregoja zotit Gucati
13 transkriptin që është prova materiale P004-ET krahas për krahas,
14 në krahas të P0004-AT dhe ky është informacion publik. Dhe
15 është faqja 2, konkretisht.

16 Më falni, një gabim nga ana ime. Kërkoj ndjesë. Është
17 faqja 3.

18 Py. Ju thoni -- kjo është një intervistë që keni dhënë për
19 gazetarin që ishte i pranishëm më 17 shtator 2020, bashkë me
20 zotin Tom Gashi, menjëherë pasi oficerët e ZPS-së kishin
21 kërkuar dorëzimin e dokumenteve. Edhe ju thoni para kamerave:

22 "Meqë jemi këshilluar nga avokati -- me këshillën e
23 Tomës, avokatit, ne veç i dorëzuam dokumentet sot. Ju, media,
24 keni marrë më shumë se 70 për qind të materialeve. Ju, mediat,
25 i keni marrë dje. Disa të tjera i mori media edhe sot".

1 A pajtoheni, zoti Gucati, që deri në momentin që erdhën
2 oficerët e ZPS-së të merrnin dokumentet në 17 shtator, ju
3 ndërkohë i kishit shpërndarë medias më shumë se 70 për qind të
4 materialeve që kishit në zotërim; apo jo?

5 Pë. Kjo është një konferencë shumë reale. Para zyrës sime që
6 kam folë. Po unë s'kam shpërnda dokumentacion. Unë s'i kam
7 thënë asnjë gazetari "Shko merr dokumentacione apo mos merr".
8 Dokumentet kanë qenë mbi tavolinën e konferencës dhe kush kanë
9 qenë të interesum kanë mujt me i fotografu edhe me marrë, po
10 jo t'i them unë "merri". Kjo është shumë e vërtetë që kam
11 thënë mbi 70 për qind janë marrë të dokumenteve, por unë s'i
12 kam thënë kërrkujna "merr dokumente". Nëse ke diku një
13 incizim, e qet këtu përpara dhe s'prish punë hiç, absolut gjë
14 s'pengon.

15 Py. Pra, mbi 70 për qind e dokumenteve u morën nga shtypi të
16 cilat ju ia kishit vënë në dispozicion shtypit gjatë
17 konferencës së dytë për shtyp, pra, i kishit vënë mbi
18 tavolinë; a është kështu?

19 Pë. Unë dokumente s'i kum japë kërrkujna. Kush ka dashtë ka
20 marrë. Është reale që unë e kam thënë mbi 70 me hamendje, se
21 nuk e di sa ka qenë numri duke mbetë edhe sa kanë marrë. Kjo
22 është me hamendje, që kam thënë gjithmonë, përafërsisht mbi 70
23 apo 70 për qind. Kështu që është reale që kam thënë. Po
24 dokumente asnjë gazetari s'i kam thënë "shko lart edhe merri
25 dokumentet". Asnjë gazetari. Asnjë mediumi. Kjo është shumë

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 53

1 reale që po them.

2 Py. Pjesë e dokumentacionit, e materialeve ju shpërnda medias

3 jo vetëm në 16 shtator por edhe më 17 shtator. Këtë keni

4 deklaruar këtu kur thoni, "Ju, mediat, i morët dje. Edhe disa

5 të tjera i mori media edhe sot". A është kështu, zoti Gucati?

6 Pë. Shumë e vërtetë është. Se mediat kanë marrë edhe më 16,

7 edhe me të 17-n, po jo që unë i kam thënë dikuj "merr

8 dokumente në tavolinë". Jo që i kam thënë dikujt. Kush kanë

9 qenë të interesum i ka marrë. Kush kanë dashë. Jo me fjalën

10 time, që unë i kam thënë "merri".

11 Py. Në 17, si i mori media dokumentet? Ku erdhën ata që i

12 morën dokumentet, materialet?

13 Pë. Më 17 ata kanë ardhë kur e kanë pa hetuesit e zyrës, që

14 kanë ardhë në zyrën time. Edhe ato dokumente janë marrë në

15 prezencën e hetuesve të juaj, që sa kanë qenë në zyrën time

16 hetuesi juaj që fliste shqip.

17 Py. Pyetja ime ishte tjetër, zoti Gucati. Ju këtu thoni "Edhe

18 sot kanë marrë mediat disa", pra, ka marrë edhe më 16 shtator

19 dhe më 17 shtator. Tani lidhur me datën 16 shtator, na thatë

20 që i kishit vendosur dokumentet mbi tavolinë gjatë kohës që

21 mbahej konferenca për shtyp dhe media mori çfarë dëshiroi. Po

22 pyetja ime ka lidhje me datën 17, të nesërmen. Të nesërmen si

23 i mori media atë pjesë të dokumenteve lidhur me Paketën 2? Ku

24 dhe kur i morën?

25 Pë. Po, pikërisht unë po flas për datën 17 shtator. Unë isha

1 në takim me inspektorin e ju apo me hetuesin e ju që fliste
2 shqip. Media ka qenë korridori plot. Dhe disa media me siguri
3 i kanë ngjitur naltë, kanë shku, kanë fotografu dhe kanë marrë.
4 Dhe unë ju kam thënë bashkë kështu është, qysh është deklarata
5 edhe Josef -- hetuesit të ju që fliste shqip i kam thënë "Që
6 mbi 70 për qind dhe në media i kam thënë, para mediave ua kam
7 thënë që i keni marrë ju". Kjo është reale. Unë s'jam duke i
8 mohuar këto.

9 Edhe i kam thënë hetuesit "Shko merri dokumentacionin
10 naltë se mediat mujn i marrin të gjitha". Kjo ka qenë e
11 vërtetë. Edhe kjo është para mediave që kam thënë "Ju, mediat,
12 i keni marrë mbi 70 për qind". Unë s'jam duke i mohu këto.
13 Mesa po muj [e pakuptueshme].

14 Py. Pra, në datën 17, dokumentet ishin ende në zyrën tuaj të
15 disponueshme, pra, në dispozicion që media të mund të merrte
16 faqe; a është kështu? Pra, ishin ende aty edhe media mund të
17 merrte faqe?

18 Pë. Ky nuk është faji im. Kur unë i kam bërë thirrje hetuesve
19 të Kosovës edhe të Gjykatës Speciale që të vini edhe ta ruani
20 objektin, se kush po na i dorëzon këto dokumentacione dhe të
21 vini t'i merrni këto dokumentacione. Ata s'kanë ardhur më
22 datën 16, që unë ju kam bërë thirrje, kanë ardhur më datën 17.
23 Dhe mediat kanë ardhur më datën 17, është shumë e vërtetë dhe
24 i kanë marrë një pjesë të tyre. Kështu që s'e mohoj. Ato kanë
25 qenë -- ne s'i kemi ru ato dokumente. Kanë qenë mbi tavolinë.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 55

1 Se s'kanë qenë dokumente tona për me i ru ne. Kjo është reale.

2 Py. Ju nuk e ndaluat median. Nuk i thatë medias të mos i

3 merrte dokumentet; apo jo? Nuk e ndaluat median që t'i merrte

4 dokumentet?

5 Pë. Që të bëheni i singertë, unë isha në zyrën time. Nuk i

6 kam pa kur janë ngjit nalt, atje në katin përsipër të

7 dokumentacionit. Po edhe të isha aty nuk do të kisha ndalu, se

8 ata kanë ardhë me bë fotografi me dokumentacione. Dhe besoj se

9 ato kanë qenë media të njëjta të datës 16.

10 Py. Faleminderit. Zoti Gucati, ju e dinit se dokumentet e

11 TFHS-së dhe ZPS-së në paketën e parë dhe të dytë, që i vutë në

12 dispozicion të medias, ishin konfidenciale; apo jo?

13 Pë. Unë, singertë, nuk e kam ditë deri vonë. Nuk i kam pa

14 kombinicionet që ka shënu. Po unë e kam thënë edhe me kohë që

15 ato dokumente nuk e kemi pa të arsyeshme që ne të jemi

16 sigurimi i atyne dokumenteve apo t'i ruajmë. Se nuk kanë qenë

17 dokumente tona.

18 Py. Kuptoj.

19 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do të doja t'ju tregoja provën

20 materiale P00059-ET krahu për krahu me P00059-AT. Nëse mund ta

21 zmadhojmë pak versionin në gjuhën shqipe.

22 Kjo është postim në Facebook, zoti Gucati, më 21 shtator

23 2020, në profilin e Hysni Gucatit, nënshkruar me emrin dhe

24 mbiemrin tuaj dhe titullin "Kryetar i Organizatës së

25 Veteranëve të Luftës".

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 56

1 Nëse mund të shkojmë pak tek faqja e tretë e versionit
2 shqip, për t'ju treguan nënshkrimin firmën. Më falni, faqja e
3 katërt. Ta zmadhojmë pak pjesën e fundit.

4 Py. A është ky postimi juaj, zoti Gucati?

5 Pë. Po, postimi im është.

6 Py. Dhe ju e keni publikuar në profilin tuaj në Facebook; apo
7 jo?

8 Pë. Nëse në shekullin e 21 nuk kam të drejtë të mendoj
9 ndryshe dhe të flas lirshëm, atëherë është mirë me më tregu
10 pse s'kam të drejtë unë, si qytetar i çdo vendi atëherë edhe
11 unë kam të drejtë të mendoj ndryshe dhe të flas lirshëm.
12 Kështu është mendimi im i lirë ky çka kam shkruar dhe mund ta
13 lexojmë në gjuhën angleze, Gjyqtarë të nderum.

14 Py. Faleminderit. Dhe e publikuat në profilin tuaj në
15 Facebook; apo jo?

16 Pë. Unë e thashë, shumë e vërtetë është.

17 Py. Faleminderit.

18 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nëse shohim faqen tetë -- pra,
19 nëse shohim faqen 081985 si në versionin shqip dhe në
20 versionin anglisht.

21 Py. Nga fundi i paragrafit të parë thuhet:

22 "Dosjet që janë dorëzuar ne përmbanin korrespondencë
23 midis Serbisë dhe Dhomave e Specializuara; këto janë prova dhe
24 nuk duhet të jesh ekspert i fushës për ta kuptuar këtë".

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do të doja t'ju tregoja tani në

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 57

1 faqen -- një moment, ju lutem.

2 Py. Të njëjtën faqe --

3 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Një moment, i
4 nderuar, sepse humba referencën.

5 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

6 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

7 Py. Të njëjtën faqe pas fjalisë që unë lexova, thuhet:

8 "Veç kësaj, lidhur me rrjedhjen e këtyre dokumenteve dhe
9 korrespondencën midis Serbisë dhe Dhomave të Specializuara
10 kundër OVL-së, jemi habitur se kush i nxori këto dokumente
11 konfidenciale dhe për proceset duhet drejtuar - më falni, se
12 humba pjesën - në Dhomat e Specializuara që janë në Gjykatë.
13 Ju vetë aty thoni, pra, fjala kryesore është që këto dokumente
14 thoni që janë dokumente shumë sensitive dhe konfidenciale. Ju
15 vetë e kishit kuptuar që këto dokumente ishin sensitive dhe
16 shumë konfidenciale; apo jo?

17 Pë. Këtë e ka kuptuar mbasi kanë ardhur hetuesit e juaj.

18 Py. Në kohën, momentin kur patë dokumentet më 7 dhe 16
19 shtator, a i kishit parë ju më përpara dokumente të tilla në
20 publik?

21 Pë. Është fjala për para 7 shtatorit apo? Edhe njëherë nëse
22 ka mundësi pyetjen?

23 Py. Më datën 7 shtator, kur patë për herë të parë dokumentet,
24 këto dokumente i kishit parë ndonjëherë më përpara publikisht?

25 Pë. Jo që i kisha parë, po as që i kisha mendu ndonjëherë në

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 58

- 1 jetën time që do të vijmë këto dokumentacione në zyrën time.
- 2 Jo, s'kam pa kurrë para 7 shtatorit, po as e kisha mendu që do
- 3 të vijmë në zyrën time. Kjo ka qenë një ëndërr. Po them
- 4 singërisht, ka qenë një ëndërr kur kanë ardhur në zyrën tonë.
- 5 Jo, para 7 shtatorit s'kam pa, as kam dëgjuar kurrë. S'kam
- 6 dëgjuar, as kam pa.
- 7 Py. Sepse dokumente të tilla nuk ishin të disponueshme për
- 8 publikun deri në ato momente, apo jo?
- 9 Pë. Këto dokumente që kanë ardhur në zyrën tonë, unë nuk e
- 10 di, s'kam dëgjuar para 7 shtatorit. Unë nuk e di. Nuk kam,
- 11 s'kam njohuri për këtë temë.
- 12 Py. Faleminderit. Ishte ëndërr të merrje dokumente të tilla,
- 13 zoti Gucati? Zoti Gucati, ju thatë vetë pak më përpara: Se kur
- 14 mora dokumentet ishte si në ëndërr.
- 15 Pse ishte si në ëndërr të merrje dokumente të tilla?
- 16 Pë. Po s'kisha besu. Me më pas thanë dikush që të dalin
- 17 dokumentacione nga Gjykata Speciale, s'kisha besu. Kjo është
- 18 arsyeja pse po them dhe prapë nuk besoj si ka qenë e mundur që
- 19 këto dokumente të dalin nga zyrat e juve? Kjo mund të jetë
- 20 ndonjë lajthitje, naj kurth që na keni bë neve, apo një
- 21 prapavijë që ju e dini më mirë se ne. Kështu unë e mendoj.
- 22 Py. Zoti Gucati, më 17 shtator ZPS-ja, oficerët e ZPS-së, ju
- 23 treguan urdhrin për sekuestrimin e dokumenteve; a është
- 24 kështu?
- 25 Pë. Po, hetuesi që fliste shqip, se shqip ka fol me mu tërë

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 59

1 kohën, mu drejtue si kryetar, thotë "Ne kemi ardhur t'i marrim
2 ato dokumente. Më së pari" thotë "do t'i shiqojmë a janë
3 tonat. Nëse janë tonat, ne do t'i marrim". Kështu më thotë
4 hetuesi juaj.

5 Dhe unë i them "Mundet të shkon në katin lart, ti shifsh
6 dokumentet dhe pastaj ti vendose". Dhe ai ka shkuar në katin
7 sipër, i ka fotografu dokumentet. Qysh më kanë thënë shokët se
8 unë s'kam shku naltë, për arsye të komës për me ec shkallëve.
9 Ka ardhur në zyrën time dhe më thotë "Zoti Gucati, këto
10 dokumente janë tonat. Ne duhet t'i marrim dhe më tregon" thotë
11 "e kemi urdhnesën" dhe unë i them me kënaqësinë më të madhe
12 "Shko merri" dhe e kemi bërë raportin dorëzim-pranimin të
13 dokumentacionit. Kjo është reale.
14 Py. Oficeri i ZPS-së a ju tregoi dhe urdhrin e gjyqësorit për
15 sekuestrimin dhe mosnxjerrje të mëtejshme të këtyre
16 dokumenteve?

17 Pë. Të jem i sigurtë, që këtu mund të gaboj, nuk më
18 kujtohet. Vetëm e di që dorëzim-pranimin po, ka qenë urdhri,
19 që është dhe dokumenti ekzistues. Për këtë urdhër muj të
20 gaboj. Nëse është, është mirë me na tregu. Nuk është problem.
21 Nëse e kam nënshkruar unë, s'është problem fare. Unë do ta
22 pranoja, po nuk më kujtohet si rast, se kisha media në
23 korridor. Kemi qenë në tension atë ditë, kështu që nuk më
24 kujtohet. Nuk e kam të qartë. Muj të gaboj këtë rast.

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do të doja t'i tregoja

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 60

1 dëshmitarit një pjesë të shkurtër të një video P004. Është
2 publike. Dhe pjesa përkatëse është që nga fillimi deri në 12.
3 Dhe pjesa korresponduese e transkriptit është P004-ET, faqja
4 1. Është informacion publik.

5 [Luhet videoincizimi]

6 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

7 Py. Këtu, zoti Gucati, ju dhe Tom Gashi po i tregoni kamerave
8 urdhrat e Gjykatës që sapo iu treguan ju pak minuta më para
9 nga oficerët e ZPS-së bashkë me formularin e dorëzimit që ju e
10 nënshkruat; a është kështu?

11 Z. REES: [Përkthim] A mund ta pyes zonjushën Bolici të na
12 konfirmojë gjuhën e këtyre dy dokumenteve? Çfarë gjuhe ishin
13 këto dokumente?

14 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mund ta zmadhojmë imazhin. Mund
15 ta bëjmë më të madh dhe do jua tregoj dëshmitarin dhe
16 dokumentin konkret për një moment, nëse mund të më prisni pak.

17 Zmadhojmë pak imazhin ju lutem, zonja Sekretare e
18 Gjykatës. Është në rregull?

19 Z. REES: [Përkthim] A mund ta identifikoni gjuhën ju
20 këtu? A mund ta dalloni çfarë gjuhe është?

21 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faqja e parë që mund të shohim ne
22 në ekran është urdhër anglisht, zoti Rees.

23 Py. Zoti Gucati, ju e dinit në këtë pikë, në këtë moment se
24 urdhri që morët nga oficerët e ZPS-së dhe që ju po ja tregoni
25 kamerave, thuhej në urdhër se "Nuk duhej të shpërndahej më tej

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 61

1 apo të kopjohej në tej materiale të TFHS-së, të ZPS-së që ju
2 kishit marrë, a është kështu?
3 Pë. Jo, nuk është. Arsyerja: Në dorën e majtë është dorëzim-
4 pranimi i dokumentacionit që e ka Tom Gashi në dorë. Në dorën
5 e djathtë është në gjuhën angleze. Ku më është thënë mu që ky
6 dokument është për marrjen e dokumentacionit, që Gjykata
7 Speciale çon urdhër për marrjen e dokumentacioneve. Kështu më
8 është konfirmu. Kjo është. Shumë i bindur jam për këtë punë.
9 Kemi qenë në zyrë bashkë me hetuesin e ju, që folke në gjuhën
10 shqipe. Dokumenti në dorën e majtë të Tomës është dorëzim-
11 pranimi i dokumentacionit. Dokumenti në dorën e djathtë, mu më
12 është konfirmu, se unë në gjuhën angleze nuk e di, është
13 vendim apo urdhër nga Gjykata Speciale për të marrë
14 dokumentacionin. Kështu është e vërtetë. Unë e di kështu.
15 Py. Zoti Gucati, juve ju thanë, në këtë moment ju kishin
16 thënë, se ky urdhër përmbante ndalimin e shpërndarjes së
17 mëtejshme dhe nxjerrjes së më tejshme të dokumenteve; apo jo?
18 Ju kishin thënë?
19 Pë. S'e di kush më ka thënë. Se hetuesi ju fliste gjuhën
20 shqipe. Ai vetëm më ka thënë, s'është mirë kjo çka ka ndodhë.
21 Dhe këtë urdhër nuk e kam nënshkruar unë fare. Kështu që është
22 mirë me nxjerrë edhe nënshkrimin e këtij urdhri. Nëse e keni
23 dokumentin ju, është mirë t'jua jepni Gjyqtarit të nderum të
24 verifikojë a është nënshkrimi im këtu. Se unë çdo dokument kam
25 nënshkru. Sa herë kanë ardhur hetuesit e ju, unë e kam

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 62

1 nënshkruar. Qe, këtu nënshkrimi im është në dorën e majtë të
2 dokumentacionit është nënshkrimi im. Kjo është reale. Qe ku
3 është Hysni Gucati dhe është nënshkrimi im përfuni të emrit
4 dhe mbiemrit.

5 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do të doja t'i tregoja
6 dëshmitarit transkriptin për të njëjtën provë materiale por në
7 faqen tetë të transkriptit. Do të doja nëse mund të vendosim
8 në ekran edhe versionin në gjuhën shqipe të transkriptit, po
9 ashtu në faqen tetë.

10 Py. Ju thoni para kamerave në këtë rast:

11 "Ata m'u drejtuan, këtu është shkruar, që thuhet vetëm
12 shumëfishimi nuk mund të bëhet edhe as shpërndarja e tyre, -
13 thotë - se nuk mund të bëhet".

14 Keni thënë para kamerave se urdhri thoshte se
15 shumëfishimi i materialeve nuk bën, apo jo, zoti Gucati?

16 Pë. Këtu unë thashë edhe ma herët që hetuesi juaj na ka
17 thënë me gojë "Ju kisha lut mos shumëzoni, mos e shpërndani"
18 na ka thënë me gojë. Dhe ne i kemi thënë "Nuk është interesi i
19 joni që të shumëzohet dokumentacione, se s'na hyjnë në punë".
20 Është shumë reale. Dhe ne, është shumë reale, se s'kemi
21 shumëzuar asnjë dokument. Dhe na ka thënë hetuesi juaj që edhe
22 këtu është shumë mirë, që "Është mirë të mos përmendni
23 deklaratat dhe mos përmendni emra". Kjo shumë reale. Q'është na
24 ka thënë hetuesi juaj që fliste shqip. Dhe ne, asnjë emër s'e
25 kemi përmendur dhe asnjë deklaratë s'e kemi lexuar të ndonjë

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 63

1 dëshmitari. Ju kena përmbajtë të gjitha atyne që na kanë
2 sugjeruar.

3 Py. Dhe keni raportuar gjatë kësaj interviste, që vërtetë,
4 hetuesit kështu kishin thënë. Pastaj thatë:

5 "Këtë më kanë thënë në këtë urdhrin këtu. Këtu shkruhet
6 për të thënë që vetëm, pra, që shumëzimi që nuk mund të bëhet
7 a sikurse edhe shpërndarja - pra, e thotë - këtë nuk bën".

8 Pra, e keni fjalën lidhur me atë që ishte shkruar në
9 urdhër, në urdhrin që ju ja tregoni kamerave në atë moment,
10 zoti Gucati?

11 Pë. Jo, jo. Me gojë na ka thënë. Me urdhër, me letër të
12 shkruar nuk kam parë. S'kam pasë. Me gojë më ka thënë. Hetuesi
13 juaj që fliste shqip, më ka thënë me gojë mes katër syve ul në
14 tavolinë, kemi qenë tu pi kafe. Ka qenë edhe një hetues suedez
15 dhe një përkthyes apo nuk e di çka ka qenë ai me ta, po ka qenë
16 edhe një përkthyes ka qenë. Aty kemi qenë unë, Nasimi, Fatoni,
17 Toma ka qenë. Kështu që më thotë me gojë, jo me diçka me letër
18 s'kam pa unë. Unë s'kam pa, se po të kisha do ta kisha
19 nënshkruar dokumentin, se unë e di çka do të thotë pranim-
20 dorëzimi dhe di çka do të thotë dokumenti që duhet nënshkruar
21 çdo marrëveshje. Po ky ma ka tërheq vërejtjen me gojë. Më ka
22 thënë me gojë, jo me dokument diçka jo. S'e kam pa unë.

23 Py. Zoti Gucati, përpara kamerës aty ju tregoni urdhrin e
24 Gjykatës që sapo e keni marrë. Flisni për atë çka është
25 shkruar në ftesë aty. Sepse ju thoni që është shkruar këtu, që

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 64

1 shumëzimi i tyre s'mund të bëhet, nuk mund të shpërndahen.

2 Sot po thoni që ajo që shkruhej aty është që dokumentet
3 nuk mund të shpërndahen apo ka të bëjë me diçka tjetër, këtë
4 po thoni sot?

5 Pë. Jo, unë po të them çka kam thënë dje, sot edhe do të them
6 gjithë. Hetuesi juaj mu më thotë "është e ndalume që të
7 shumëzohen dokumentacionet apo të shpërndahen", me gojë jo
8 diçka me shkrim. Me shkrim ka qenë urdhër për t'i marrë
9 dokumentacionin. Dhe në dokumentacionin e majtë, që thashë ma
10 herët, që është në dorën e majtë të Tomës, është dorëzim-
11 pranimi i dokumenteve. Kjo është krejt.

12 Py. Zoti Gucati, pasi morët urdhrin më datë 17 shtator, ju
13 erdhi dhe një paketë tjetër materialeësh me vulat zyrtare të
14 ZPS-së më datë 22 shtator të vitit 2020; kështu ndodhi?

15 Pë. Para se të kaloj tek kjo pyetje, unë urdhër nuk kam
16 marrë. Se mos ta devijojmë këtu të kem marrë urdhër e të jem
17 unë fajtor që kam marrë. Unë s'kam marrë urdhër. Unë e kam
18 marrë një dokument që është e ndalume të -- që kanë ardhur t'i
19 marrin dokumentet hetuesi ju.

20 Tash tek data 22, është shumë reale, ka ardhur Paketa 3
21 me shumë pak dokumente.

22 Py. Zoti Gucati, meqë ju kthyet urdhrin. Na thatë se hetuesi
23 të tha që dokumentet nuk duhen shpërndarë. Dhe para kamerës ju
24 thoni se ai -- që këtu që shkruan, që thotë se "vetëm
25 shumëzimi i tyre s'mund të bëhet".

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 65

1 Kur thoni që shkrun këtu që "shumëzimi i tyre s'mund të
2 bëhet", e keni fjalën me ato çfarë tha hetuesi apo e keni
3 fjalën për atë çka shkrun urdhri që keni përpara, që ju shumë
4 mirë e kuptuat që thotë se nuk lejohet shpërndarja e
5 mëtutjeshme e dokumenteve?

6 Pë. Jo, e nderume. Ato që ma ka thënë me gojë, se jo ç
7 shkruhet, po ç ma ka thënë me gojë. Se unë mund të jem, të
8 them që s'më ka thënë. Unë thashë e falënderoj punën e tij ç
9 ka bërë edhe sjelljet e tina me neve. Ai na ka tërheq
10 vërejtjen me gojë.

11 Dhe për sa i preket paketës 22 shtator, po ka ardhur
12 paketa me disa dokumentacione. Jo shumë s'ka pasë. Po mendoj
13 paketë s'ka pasë, po i ka gju në korridor, dokumentacionin e
14 ka gju në korridor se s'ka pasë paketë.

15 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj t'ju tregoj tani, zoti
16 Gucati, provën materiale me numër P00053-AT, është dokument
17 publik, krah për krah, ju lutem, me numër P00053.

18 Z. REES: [Përkthim] A mund të na e thotë datën të
19 përkthimit në anglisht dhe në shqip.

20 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] 17 shtator 2020.

21 Z. REES: [Përkthim] Po data e shqipes?

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] 18 shtator 2020.

23 Py. Zoti Gucati, a është ky urdhri që morët më datë 17
24 shtator 2020?

25 Pë. Po. Ky është --

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 66

1 Z. REES: [Përkthim] Po nuk mund të jetë shqipja se
2 shqipja është bërë një ditë më pas. Pra, ju lutem, pyetjen më
3 specifike.

4 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po. Urdhri që paraqitet djathtas,
5 në anën e djathtë të ekranit, a është urdhri që ju keni marrë
6 më datë 17 shtator 2020?

7 Pë. Ky është vendim për autorizimin e sekuestrimit të
8 dokumentacioneve, jo vendim, urdhër për ndalim apo diçka. Mund
9 ta lexoni vendim për autorizimin e sekuestrimit, që do të
10 thotë vendim për marrjen e dokumenteve.

11 Py. Dhe, siç e kuptuat ju këtë urdhër, ju e raportuat para
12 kamerave atë ditë; apo jo?

13 Pë. Ne këtë urdhër e kemi kuptuar që do t'ia japim
14 dokumentacionin inspektorit të juaj, i cili ka ardhur dhe i ka
15 marrë dhe na ja kemi jep dokumentacionin gjithë që ka qenë
16 nalt. Kështu e kemi kuptuar që është urdhër për t'ia dhënë
17 dokumentacionin.

18 Py. Dhe gjatë konferencës për shtyp që ju zhvilluat me Tom
19 Gashin ju i raportuat shtypit, ja përshkruat shtypit
20 përmbajtjen e këtij urdhri; apo jo?

21 Pë. Nuk më kujtohet. Është mirë, nëse është incizimi, është
22 mirë me e lëshu se nuk më kujtohet. Unë veç i kam tregu se
23 kanë ardhur hetuesit e Gjykatës Speciale me një urdhër për
24 sekuestrimin e dokumentacioneve. Këtë e di që e kam thënë dhe
25 ne ju kemi përgjigj në mënyrën pozitive hetuesve të ju.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 67

1 Py. Pra, ajo çfarë ju thatë para kamerave reflekton në fakt
2 atë që siç e kuptuat ju aso kohe e kishte përmbajtjen ky
3 urdhër?

4 Pë. Unë e kam kuptuar gjithmonë se është vendim për
5 sekuestrimin e dokumentacioneve. Kështu e kam kuptuar dhe
6 ashtu e kam thënë. Dhe ashtu e them edhe sot.

7 Py. Në rregull. Ajo që ju thatë para kamerave ishte ajo siç e
8 kuptonit ju këtë urdhër; apo jo?

9 Pë. Unë siç e kam kuptuar dhe siç po shkrun këtu, kështu kam
10 thënë dhe e kam thënë që na u ka tërheq vërejtja me gojë, jo
11 diçka me shkrim. Se thashë gjuhën angleze nuk e di. Nuk e kam
12 lexuar, po çdo dokument unë e kam nënshkruar. Unë besoj se
13 nëse kam nënshkruar, ju e keni, është mirë ta bëni publike
14 dokumentin e datës 17 shtator.

15 Py. Zoti Gucati, do të flasim për transkriptin siç është.

16 Të kalojmë tani tek data 22 shtator 2020. Më datë 22
17 shtator, morët një paketë tjetër materialesh me vulën zyrtare
18 të ZPS-së; a është kështu?

19 Pë. Po. Unë isha në zyrë. Ka ardhur zotnia, ka dalë prej
20 lifti dhe i ka gju ato dokumente në korridor. Se paketë nuk ka
21 pasë, disa qindra muj të them. Shumë pak. Edhe i ka gju në
22 korridor, i ka gju dokumentacionin. Është transkripti këtu.
23 Mund ta shohim edhe në video, që shifet shumë qartë kur del
24 prej lifti dhe i gjun në korridor dokumentacionin.

25 Py. Kur i patë dokumentet së bashku me zotin Nasim Haradinaj

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 68

1 dhe zotin Faton Klinaku dhe anëtarët e tjerë të komitetit të
2 Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së, e kuptuat se
3 këto dokumente përshkruanin akuza të mundshme kundër të
4 akuzuarve të ZPS-së; apo jo?

5 Pë. Po.

6 Py. Dhe e kuptuat se dokumenti që përfshinte edhe emrat e
7 dëshmitarëve të cilët i kanë dhënë dëshmi ZPS-së; apo jo?

8 Pë. Jo, dëshmitarë unë s'kam pa, as që kam kontrolluar. Të
9 jem i sinqertë, jo.

10 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj tani, zoti Gucati, që të
11 tregoj transkriptin e konferencës së tretë për shtyp me numër
12 P00035-AT, faqe 1, krahas krahas me P00035-ET, faqe 1.

13 Zonja Sekretare, ju lutem versionin e redaktuar të
14 vendosni në ekran.

15 Py. Në paragrafin e parafundit, fjalia e fundit, keni thënë
16 gjatë konferencës për shtyp:

17 "Ka njerëz të ndryshëm, emra të ndryshëm këtu të cilët
18 nuk na lejohet t'i themi".

19 Cilat emra njerëzish nuk ju lejohet që t'i thoni, për
20 cilët e keni fjalën në këtë pjesë këtu?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Më falni,
22 ju po kërkon që ai të përmend emra, emra të cilët janë të
23 mbrojtur.

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo, nuk po kërkoj emrat.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju kërkuat

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 69

1 emra.

2 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

3 Py. Për çfarë keni fjalën kur thoni se ka emra të ndryshëm --

4 Z. REES: [Përkthim] Mund të ngre një kundërshtim? Unë

5 nuk kam problem që ta bëj pyetjen Prokurorja, por kam problem

6 se zoti Gucati nuk mund të përgjigjet dot lirisht. E keni

7 penguar ju që të përgjigjet lirisht, a është e mundshme.

8 Sepse nëse bëhet pyetja atij duhet t'i jepet e drejta që të

9 përgjigjet plotësisht ose zonja Bolici të mendojë që t'i qaset
10 ndryshe kësaj teme.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Edhe ne

12 kështu mendojmë. Nëse ju duhen vërtetë këto emra, mund të

13 bëjmë seancë private.

14 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] S'po kërkoj emra. Po kërkoj

15 sqarim, kur thotë që "Ka njerëz të ndryshëm, emra të ndryshëm

16 këtu të cilët nuk na lejohet që t'i nxjerrim", për ç'kategori

17 njerëzish e ka fjalën.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Atëherë

19 bëjani kështu pyetjen.

20 Zoti Gucati, a e kuptoni që nuk duam që të na jepni emra?

21 E kuptoni që nuk duam që të na thoni emra? Në rregull.

22 Faleminderit.

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

24 Py. Zoti Gucati, pa përmendur emra, nga e dinit ju që kishte

25 emra në këto dokumente të cilët nuk mund të nxirreshin?

1 Pë. Është shumë reale që unë s'kam nxjerrë asnjë emër. Dhe
2 është shumë reale këtu ça shkrun. Ka figura të ndryshme kam
3 thënë, emra të ndryshëm. Ne s'jemi të autorizum t'i përmendim
4 këta emra. Kjo është shumë reale që kam thënë. Ne e kemi thënë
5 edhe atëherë, edhe sot po them, që është mirë që Prokuroria e
6 Kosovës, në atë kohë kam thënë, edhe Prokuroria apo Gjykata
7 Speciale të hetojë këtë njeri kush po i sjellë këta emra këtu
8 te na.

9 Kështu kam thënë. Mundni ta lexoni tekstin. Është mirë
10 ta lexoni të gjithë draftin, jo vetëm një rresht apo vetëm ato
11 ku juve dëshironi. Po është mirë të thoni ato ça kam thënë unë
12 në tërë tekstin. Kështu që është mirë t'i tregoni edhe
13 gjyqtarëve.

14 "Ka figura të ndryshme, emra të ndryshëm që ne s'jemi të
15 autorizuar t'i përmendim. Këto është mirë t'i hetojë edhe
16 Prokuroria por edhe ndërkombëtarët, Prokuroria ndërkombëtare",
17 kështu kam thënë edhe prapë po them. Është mirë të hetohet ky
18 njeri kush i ka pru këto dosje në zyrën e organizatës. Kjo
19 është.

20 Emra s'kam pa edhe po të kisha pa kisha kërkuar seancë të
21 mbyllur dhe jua kisha thënë. Po sinqerisht s'kam lexuar emra
22 duke ditur se ne faqen e parë kemi lexuar një deklaratë të
23 parë që thotë aty që ka dëshmi të ndryshme. Kështu që nuk i
24 kam pa emrat.

25 Pë. Kur thoni këtu që ka emra të ndryshëm të cilët nuk

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 71

1 na lejohet t'i nxjerrim, e keni fjalën për emra dëshmitarësh
2 që nuk ju lejohet t'i nxirrni?

3 Pë. Jo, kjo ka qenë për tash. Po ajo ka qenë propozim-
4 aktakuza. Ne ato emra s'kemi dashë, përmendur te propozim-
5 aktakuza, që ju e dini fort mirë që ka dalë muajin e gjashtë a
6 kur ka dalë. Kështu që unë emra s'kam pa. Po të them
7 singërisht. Se po të kisha pa emra, do t'i kisha kërkuar
8 Trupit Gjykues seancë të mbyllur dhe do t'i kisha përmend dy a
9 tre a katër. Ju them me singëritetin më të mirë. Kështu që
10 emra s'kam pa.

11 Py. Kur thoni "Ka emra të ndryshëm këtu për të cilin s'e kemi
12 autorizimin me i përmend" a e keni fjalën për emra
13 dëshmitarësh apo për ç'tjetër e keni fjalën?

14 Pë. Unë mesa di, këtu s'kam përmend emra dëshmitarësh fare.
15 Ka thënë s'jam i autorizim të përmendi emra. Po është teksti
16 në gjuhën angleze që mund ta lexojnë. Unë kam thënë ka emra,
17 nuk kam përmend as emra dëshmitarësh, as emrat e aktakuzës.
18 Kjo është shumë reale. Kështu që unë kam thënë vetëm ka emra.
19 Më nuk e kam çu më lart se kam thënë, s'jam i autorizim që unë
20 të përmendi ndonjë emër apo ndonjë tekst apo ndonjë deklaratë.
21 Kështu kam thënë.

22 Py. Keni thënë se nuk e keni autorizimin me i përmend emrat e
23 dëshmitarëve. Për këtë e keni fjalën zoti Gucati; apo jo?

24 Pë. Jo, jo. S'kam thënë dëshmitarë. Këtu nuk shkrun kurrkund
25 dëshmitarë. Kështu që munda me e lexu tekstin krejt. S'kam

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 72

1 përmend -- unë kam thënë ka emra. Po s'kam përmend as
2 dëshmitar, as po të akuzuar dikujna. Veç kam thënë ka emra të
3 ndryshëm. Është shumë reale. E kam thënë ka emra të ndryshëm,
4 që unë s'kam autorizim të përmendi asnjë emër. Se nuk guxoj se
5 ligji ma cungon këtë të drejtë.

6 Py. Zoti Gucati, do të mbështetem në faqen pasardhëse të
7 transkriptit.

8 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Është faqja numër 2. Edhe kjo
9 është e redaktuar. Është zoti Haradinaj i cili po flet tani.
10 Py. Në pjesën e poshtme të faqes thotë:

11 "Jemi konsultuar me avokatin që na ka thënë se me
12 përjashtim të emrave që përmenden këtu, se ka emra këtu, në
13 bazë të të cilëve i kanë ngritur, pra, në bazë të të cilave i
14 kanë ngritur aktakuzat".

15 A është e vërtetë, zoti Gucati, se emrat që ju mendonit
16 se nuk kishit autorizim t'i përmendni ishin emra dëshmitarësh
17 të cilët përmendeshin në dokumentet që kishit përpara?

18 Pë. Me thënë sinqerisht, unë nuk po di ku je tuj lexu. Q'ato
19 me gjetë se jam tuj lyp kështu. E ke fjalën te zoti Haradinaj
20 apo te...

21 Py. Janë fjalët e zotit Haradinaj. Dhe gjatë konferencës për
22 shtyp, ju ishit ulur ngjitur, domethënë, përbri zotit
23 Haradinaj. Ai thotë këtu "emrat në bazë të të cilave kanë
24 ngritur akuzat" dhe unë ju pyes këtë këto janë emra të cilat
25 ju, se ju kështu e thatë, ishin emra të cilët ju si OVL UÇK

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 73

1 nuk ju lejohej që t'i nxirrnit.

2 Pra, sepse kur thoni që "ka emra të personave të ndryshëm
3 të cilët nuk i kemi autorizimin t'i përmendim".

4 A nuk po flisni të dy ju në këtë rast për ndalimin mbi
5 nxjerrjen e emrave të dëshmitarëve?

6 Z. REES: [Përkthim] A mundet që t'ia tregojmë se për
7 cilin pasazh në faqe po lexohet sepse ai e kërkoi dhe nuk iu
8 tregua.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po. Ju
10 lutem zonja Prokurore, t'ia tregoni dhe duhet t'i jepni dhe
11 mundësinë që ta lexojë vetë.

12 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po. Është brenda paragrafit që
13 fillon aty ku është vula kohore 00:06:54 deri në 00:10:28 në
14 pjesën e poshtme të faqes numër 2, midis dy shenjave të zeza.
15 S'ka as numra të tjerë që t'jua tregoj në mënyrë specifike.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
17 Gucati, e gjetët pjesën përkatëse?

18 I AKUZUARI GUCATI: 00:06:54? A është kjo?

19 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

20 Py. Po. Pastaj po të shihni në periudhën e tretë, në fjalinë
21 e tretë ose te paragrafi i tretë.

22 Z. REES: [Përkthim] A mund të hiqet nga ekrani përkthimi
23 në anglisht që të ndjekim. Mund të na tregojë se ku është në
24 përkthimin në anglisht më saktë.

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Përkthimi në anglisht fillon në

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 74

1 pjesën e poshtme të faqes 2 dhe vazhdon në rreshtin e parë të
2 faqes 3. Ndërsa në versionin në shqip është e gjitha në faqen
3 2.

4 Py. Fjalja është kjo:

5 "Ka emra këtu në bazë që janë ngrit ato, në bazë të tyre
6 janë ngritë aktakuzat".

7 A e gjetët pjesën përkatëse, zoti Gucati?

8 Pë. Po, po tash e gjeta, po.

9 Py. Në lidhje me emrat, pra, në bazë të të cilave janë ngritë
10 aktakuzat, zoti Haradinaj thotë se avokati ju ka thënë se këto
11 emra nuk mund të nxirren. Në fillim të kësaj konference për
12 shtyp, ju vetë thatë se:

13 "Ka emra të ndryshëm, njerëz të ndryshëm të cilët nuk na
14 lejohet t'i nxjerrim".

15 A është e vërtetë, zoti Gucati, se e kuptonit se në këto
16 dokumente kishte emra dëshmitarësh për të cilët se kishit
17 autorizimin për t'i nxjerrë?

18 Pë. Kjo intervistë e zoti Nasim Haradinaj më shumë bëhet
19 fjalë për aktakuza që është ngritë. Mundet ta lexoni e tërë.
20 Se kur nuk lexohet e tërë fjalja apo tërë shkrimi është
21 problem edhe ta kuptojmë edhe ne. Është mirë të lexohet prej
22 fillimit çka ka thënë zoti Haradinaj deri në fund. Këtu bëhet
23 fjalë, që thotë, që kanë ngritë disa aktakuza. Kështu bëhet
24 fjalë. Në bazë të -- të ngrihen disa aktakuza, kështu është,
25 shkrun kjo. Është mirë që të lexohet e tërë fjalja për me

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 75

1 nxjerrë kuptimi i saj. Unë as vetë s'jam tue kuptu edhe pse e
2 lexoj shqip s'jam tu kuptu. Të jeni të bindur. Kështu që është
3 mirë pej fillimit të lexohet deri në fund për me e kuptu
4 fjalinë çka dojna me nxjerrë prej saj.

5 Py. Zoti Gucati, a e kuptuat ju atëherë se në këto dokumente
6 kishte emra të dëshmitarëve për të cilët autorizimin për t'i
7 përmendur nuk e kishit?

8 Pë. Jo, jo. Unë të thashë emra kam pa. A kanë qenë dëshmitarë
9 apo kanë qenë propozim-aktakuze, kjo është diçka tjetër. Unë e
10 thashë edhe më herët, nuk e di çka kam fol për këto emra. Po
11 është shumë e vërtetë, unë kam thënë se s'jam i autorizum. Jo
12 unë, po askush në këtë botë sot s'është i autorizum të fletë
13 në emër të personit privat. Se privatësia e çdo qytetari
14 ruhet. Kështu që, ne nuk kemi të drejtë të nxjerrim emra, të
15 dëshmitarëve gjithmonë është fjala. Kështu që, ne emra s'kemi
16 nxjerrë kurrë.

17 Py. Është e vërtetë zoti Gucati, që gjatë kësaj konference
18 për shtyp publikisht u kërkuat mediave që të publikonit emrat
19 e dëshmitarëve; është kështu?

20 Pë. Unë flas vetëm për emrin tim. Unë nuk e di që një
21 gazetari apo një portali apo një televizioni t'i kem thënë
22 merri këto dokumente dhe publikoj emrat dhe mbiemrat. Unë nuk
23 e di që ka emër dhe mbiemër ai person, ai gazetar.

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj që të lëshojmë tani një
25 pjesë nga konferenca e tretë për shtyp. Është me numër P00035,

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 76

1 është konfidenciale, por pjesëza që kërkoj të lëshojmë tani
2 nuk përmban informacion konfidenciale.

3 Në transkriptin anglisht për përkthyesit është duke
4 filluar -- jo është nga faqja 13 e tutje, në veçanti -- më
5 falni, nga faqja 12 e tutje, në veçanti, duke filluar nga vula
6 kohore 00:23:15 deri në 00:24:19, në mes të faqes 12.

7 Do të doja që luhet deri në pjesën 00:26:03 -- më falni,
8 00:26:05. Pra, është tre minuta.

9 [Luhet videoincizimi]

10 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo është nga 00:23:15. Po prej
11 këtu.

12 [Luhet videoincizimi]

13 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Nëse mundet, duhet
14 të ketë një gabim në transkript sa i takon vulës kohore,
15 minutës. Pjesa që unë kërkoj është 00:24:15 dhe është në mes
16 të faqes 12.

17 [Luhet videoincizimi]

18 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Zoti Gucati, tek kjo pjesa e
19 videos një gazetar ju pyeti:

20 "Pra, ju po kërkonit t'i publikoni. Pse nuk po i
21 publikoni?"

22 Dhe zoti Haradinaj ju përgjigj që duhet t'i publikojë
23 media këto se media është shtylla e katërt, forca e katër e
24 shteti.

25 Dhe ju thoni:

1 "Doja t'ju jepja një përgjigje këtu. Keni publikuar emrat
2 e veteranëve. Ne nuk duam këtu, nuk duam -- duam të mbrojmë
3 privatësinë e personave. Ju keni publikuar emrat e plotë. Keni
4 publikuar dhe identitetin, numrin personal të letërnjoftimit.
5 Dhe tani nuk je në gjendje të publikoni emrat e tyre. Edhe ata
6 janë shqiptarë. 80 për qind e persona që dhanë dëshmi, prova
7 janë shqiptarë".

8 A nuk po ju kërkoni ju medias, zoti Gucati, të publikojë
9 emrat e dëshmitarëve shqiptarë njësoj siç kanë publikuar emrat
10 e veteranëve?

11 Pë. Para se të hij në këto detale, unë, veç e ndëgjut
12 edhe vetë që unë kam thënë, nuk është e drejtë që të
13 publikohen emrat. Ju jeni ato mediat që e keni shkelë ligjin
14 dhe keni bë publike emrat dhe mbiemrat, që qe fjala te
15 veteranët me numër personal. Dhe kjo ka qenë një tension, një
16 provokim i një gazetari që na e ka provoku Nasimin dhe jam
17 detyru të ndërhyjë. Kjo është e vërtetë, që ata kanë bë një
18 shkelje kur i kanë publiku emrat e veteranëve. Dhe unë i kam
19 tërhjek vërejtje i kam thënë "Nuk keni të drejtë, po nëse keni
20 pasë të drejtë t'i publikoni ato emra, bujrum publikojini edhe
21 këta emra". Kjo ka qenë kështu.

22 Unë s'i kam thënë merri publikoi me dhunë. Asnjë njeri se
23 kam marrë t'ia japë dokumentin me dhunë kapi, shtini në xhep
24 dhe shko ti publikoi. Po nëse "Don ti, guxon ti merre", po unë
25 nuk i them kape merre ti. Unë dhe në fillim thashë nuk është e

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 78

1 drejtë morale që asnjë personi t'i përmendet emri dhe mbiemri,
2 qysh keni bërë ju ma herët. Kështu thashë në fillim. Shumë
3 mirë aty ndigjohet zëri im. Dhe në bisedë e sipër kur ka
4 provoku gazetari, i kam thënë "Nëse ti guxon, merre publikoi
5 ti", jo nga unë. Kjo është reale çka kam thënë aty.
6 Py. Në fakt po. Dhe më pas i referohem faqes 14 të
7 transkriptit, ju thoni:

8 "Ja këtu janë materialet. Jeni të mirëpritur t'i lexoni.
9 Në të njëjtën mënyrë siç keni publikuar emrat e veteranëve".

10 Dhe thoni pastaj, në faqen 14:

11 "Merreni të gjeni të njëjtën kurajo që gjetët dhe për
12 veteranët".

13 A nuk po ju kërkoni ju këtu medias, zoti Gucati, të
14 publikojë emrat e dëshmitarëve shqiptarë në të njëjtën mënyrë
15 siç kanë publikuar emrat e veteranëve?

16 Pë. Jo. Unë e kam thënë "këto janë materialet". Dhe është
17 shumë e vërtetë, se na për këtë arsye e kem thirrë dhe
18 konferencën. Ti njoftojmë që materialet janë këtu dhe
19 përgjegjësia është mbi ta, jo mbi mu. Se unë jam me kohë e kam
20 tërhek vedin, është e ndalume të publikohen emrat apo
21 deklaratat e çdo njeri. Me qindra herë e ki nëpër transkripte
22 të tjera, edhe mbrena këtij emisioni, që kam thënë që është e
23 ndalume. Edhe kam thënë, është shumë e vërtetë, që ju jeni ata
24 të cilët keni publikuar emrat e veteranëve që s'keni pasë të
25 drejtë. Është shumë reale kjo.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 79

1 Py. Në fakt po. Mund ta shohim edhe vetë. Zoti Gucati, a e
2 dinit ju se nxirrja -- se dëshmitarët mund të dëmtoheshin si
3 pasojë e nxjerrjes së emrave të tyre publikisht; a është
4 kështu?

5 Pë. Ne s'kemi nxjerrë asnjë emër publikisht. Asnjë deklaratë.
6 Më tregoni në cilin medium ka dalë një emër i një dëshmitari
7 që kemi nxjerrë apo një deklaratë e një dëshmitari që ka jep
8 te ju. Apo unë që e kam përmend një dëshmitar X apo Y.

9 Py. Pyetja ishte ndryshe, zoti Gucati. A e dinit ju se duke
10 nxjerrë emrat e dëshmitarëve, pra, atyre 80 për qind të
11 dëshmitarëve shqiptarë që përmendni ju tek konferenca për
12 shtyp, pra, duke i nxjerrë këto emra publikisht dëshmitarët
13 mund të dëmtoheshin? A ishit në dijeni ju se mund të
14 dëmtoheshin po të nxirrnit emrat?

15 Pë. Po, pikërisht, arsyeja ime që kam thënë që s'është mirë
16 që të nxirren emrat dhe deklaratat e tyre, ata dëmtohen dhe
17 për këtë arsye kam thënë është e ndalume me ligj që të nxirren
18 emrat e tyre. Gjithkund, nëpër tubim ku kam qenë, debate
19 televizive apo edhe në konferenca ku ka qenë kam thënë është
20 ndalume me ligj edhe asnjë emër s'është dalë publik deri më
21 sot, asnjë deklaratë.

22 Py. Dhe nxjerrja e emrave të dëshmitarëve për publikun është
23 e ndaluar sepse për shembull mund të ketë ndikim tek
24 privatësia e tyre, siç ishte në rastin e veteranëve të rremë;
25 apo ajo?

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 80

1 Pë. Këtë kam thënë unë në fillim, është e ndalume dhe, prapë
2 po them, që është e ndalume çdo person që del emri i tina.

3 Py. Dhe nxjerrja e emrave të dëshmitarëve mund të dëmtonte
4 dëshmitarët sepse vihej në rrezik siguria e tyre? A pajtohesh
5 me mua, zoti Gucati?

6 Pë. Unë s'kam nxjerrë emër asnjë dëshmitari. As gazetarët, as
7 kryesia, as unë s'kemi nxjerrë një emër të një dëshmitari për
8 ta dëmtuar. Asnjë deklaratë s'kemi qit në media që kemi lexuar
9 një deklaratë të një dëshmitari.

10 Py. A pajtohesh se nxjerrja e emrave të dëshmitarëve për
11 publikun vendoste në rrezik sigurinë e dëshmitarëve? A
12 pajtohesh me këtë që vendosej në rrezik siguria e
13 dëshmitarëve?

14 Pë. Në momentin që thamë është e ndalume dhe momentin që kam
15 thënë gjithmonë nëpër çdo konferencë që është e ndalume
16 nxjerrja e emrave, le të kuptoj fjala vet, kupton që është e
17 ndalume të publikohet emri i ndonjë dëshmitari të mbrojtur.
18 Edhe është e ndalume prapë po them edhe s'e kam bërë këtë
19 asnjëherë.

20 Py. Dhe pajtoheni se nxjerrja e emrave të dëshmitarëve për
21 publikun do të vendoste në rrezik sigurinë e dëshmitarëve? A
22 pajtoheni me këtë?

23 Pë. Unë po them prapë. Nëse është nxjerrë ndonjë emër nga
24 unë apo nga kryesia apo nga gazetarët me siguri që ndoshta do
25 të kish frikë ai dëshmitar. Por ne nuk kemi nxjerrë asnjë

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 81

1 emër, asnjë deklaratë të një dëshmitari. Dhe nuk ka pse ta
2 ndjejnë veten të rrezikum ata, përderisa ne s'kemi nxjerrë
3 emër, as mbiemër. Kjo është që po them unë. Po është e ndalume
4 kjo rreptësishtë.

5 Py. Ju lutem, fokusohuni, përqendrohuni pak tek pyetja që po
6 ju bëj, zoti Gucati. A pajtoheni ju se nxjerrja e emrave të
7 dëshmitarëve për publikun vendoste në rrezik sigurinë e
8 dëshmitarëve? A pajtoheni me këtë propozim që do vendosej në
9 rrezik siguria e dëshmitarëve?

10 Pë. Ne mbasi s'kemi nxjerrë emra, as unë, as gazetarët as
11 shokët e mi, nuk e di kush të jetë mundi i rrezikum. Mund të
12 jetë ndonjë matrapaz që mund të rren, po ne s'kemi nxjerrë
13 emrat e asnjë dëshmitari. Po të kishim nxjerrë ne emra, është
14 e vërtetë se ndoshta e kish ndi veten të friksum, po ne s'kemi
15 nxjerrë emra.

16 Py. Faleminderit. A pajtoheni, zoti Gucati, se ka pasur
17 përpjekje në të shkuarën për të frikësuar dëshmitarët në
18 çështjet e krimeve të luftës kur ishin të përfshirë të akuzuar
19 nga UÇK-ja?

20 Pë. Për kenë e keni fjalën? Nuk e di.

21 Py. Nuk jeni dakord me këtë që thashë, që ka ndodhur në të
22 shkuarën se janë frikësuar dëshmitarët në gjykime ku
23 përfshiheshin krime lufte, pra, gjykime për krime lufte ndaj
24 anëtarëve të UÇK-së? Nuk pajtoheni me këtë?

25 Pë. Nuk kam pasë kohë të merrem me atë punë. Nuk e di që ka

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 82

1 pasë dikush që ka frikësu dikunin se unë isha me plagët e mia
2 t'u operu dhe kisha vajzën smurë prej leukemie për atë kohë
3 kur po flet ti. Kështu që nuk di. S'kam dëgju unë për vete se
4 dikush dikujn iu ka kërcënu. Se isha tu u marrë me punë të
5 miat private, se kisha vajzën sëmure prej leukemie në atë vit
6 edhe isha operu vetë, kështu që nuk më ka hi në punë ajo fare
7 të interesohena për ato që pyet ti.

8 Py. Zoti Gucati, më përpara na thatë se e njihnit çështjet
9 TPNJ-së për Ramush Haradinaj; apo jo? Kishit dijeni për këtë
10 çështje ndaj Ramush Haradinaj?

11 Zoti Gucati, ju na thatë përpara se e njihnit çështjen,
12 gjykimin e TPNJ ndaj Ramush Haradinaj, apo jo?

13 Pë. Çdo qytetar i Evropës dhe i Ballkanit i dinë ato
14 procedura dhe atë gjyqe që ka ndodhë ai gjykim, kështu që kur
15 kam pasë kohë e kam përcjellë përmes televizioni. Kështu që
16 unë thashë, unë jam marrë me familjen time edhe, ma herët
17 thashë, me jetën time private që i kisha vuajtjet e mia për
18 operacion edhe kisha vajzën në 2006 nga leukemia dhe më patë
19 vdekur. Kështu që, nuk jam marrë e s'më ka interesu fare. Po
20 kur kisha kohën e lirë, ndërkohë në javët apo në muajt e kam
21 përcjellë ndonjë seancë. Kështu që s'jam marrë shumë me ato,
22 që s'më ka interesuar se isha me probleme të mia private.

23 Py. Do të doja t'i referohesha aktgjykimit ndaj çështjes
24 Ramush Haradinaj nga TPNJ-ja, IT-04-84-T e 3 prillit 2008, në
25 veçanti, paragrafit 6. Është gjykim publik ku thuhet:

1 "...gjatë gjykimit Dhomat u përballën me shumë vështirësi
2 për sigurinë e dëshmive për një numër të madh dëshmitarësh.
3 Shumë dëshmitarë shprehën frikën si arsye kryesore pse nuk
4 donin të paraqiteshin para Trupit Gjykses për të dhënë prova.
5 Trupi Gjykses krijoi përshtypjen e fortë se gjykimi po
6 zhvillohej në një atmosferë ku dëshmitarët ndjeheshin të
7 pasigurt. Kjo ndodhi për një sërë faktorësh, konkretisht për
8 Kosovën, për shembull komuniteti i vogël i Kosovës edhe
9 lidhjet e ngushta familjare dhe të cilat e bënë të vështirë
10 anonimitetin. Palët ranë dakord se situata -- ekzistonte një
11 situatë e paqëndrueshme për nga pikëpamja e sigurisë në Kosovë
12 që ishte e pafavorizuese, nuk ndihmonte dëshmitarët."

13 A ishit ju në dijeni, zoti Gucati, se gjykimi ndaj Ramush
14 Haradinaj ishte ndikuar, kishte pasur vështirësi për të
15 kaluar, për të tejkaluar, pra, frikën e dëshmitarëve në mënyrë
16 që të dëshmonin?

17 Pë. Më së pari, faleminderit që ma kujtove 2008, kam
18 dokumente dhe argumente që unë isha në spitalin turko-amerikan
19 në Stamboll, si jam operuar. Kështu që viti 2008 krejt është
20 me operacionet e mia në Turqi. Kështu që fare s'jam marrë me
21 këtë punë hiç, as që jam në dijeni. Kështu që ti bi
22 dokumtacionet dhe dëshmitë që kam qenë në spital në Turqi, në
23 Stamboll. Shumë faleminderit për kujtesën që ma ktheve në
24 2008.

25 Py. Pra, zoti Gucati, i ndiqje apo nuk e ndiqje çështjen e

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 84

1 Ramush Haradinaj?

2 Pë. Në 2008 jam kanë në spital unë në Turqi. S'kam pasë ku ta
3 ndjek se as televizor s'ka pasë në spital atje, as në gjuhën
4 shqipe. E ku ta ndjek unë në spital, kur unë jam operuar në
5 2008-n. Thashë kam dhe ta tregoj edhe datën kur kam shkuar në
6 spital, se e di datën. Si sot e di, e mbaj mend. Që unë jam
7 operu në Turqi. Ka zgjatë operacioni mbi shtatë orë, që mu ka
8 dashë ta zgati këmbën për 12 centim, se unë këmbën e djathtë e
9 kam pasë për 23 centim ma të shkurtë. Kështu që unë këmbën e
10 kam zgjatë me aparat. 2008 ka qenë me operacione. Nuk ka pasë
11 shans të u rri ke mu tu më bjen në mend për Ramush Haradinin,
12 po as për babën tim në ato momente. Se unë e kisha dhe vajzën
13 që më pati vdek mbrenda atyne viteve, po kisha edhe plagët e
14 mia të trupit. Kjo është reale ça po të them. Këto t'i bie
15 dëshmi, dokumentacionin, të gjitha.

16 Py. A vutë në dijeni më pas, a u informuat më pas për
17 çështjen e Ramush Haradinaj se Gjykata kishte shprehur në
18 mënyrë publike se kishte vështirësitë që kishin ndeshur, me të
19 cilat ishin përballur në sigurimin e provave nga dëshmitarët
20 për shkak të frikësimit ndaj të cilave ishin -- frikësimit që
21 kishin dëshmitarët.

22 Pë. S'më ka hi në punë, as e kam pyet dikën për atë punë. As
23 që e di. As që jam interesuar për rreth këtyre që jeni duke
24 bërë pyetje ju. Mu më ka interesuar kur është liru i
25 pafajshëm. Ju kam gëzuar vendimit që është liru i pafajshëm.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 85

1 Kështu që ato ç'a më kanë hi në punë. Kurrë ato jo, se isha me
2 -- të thashë, të tregova kisha problemet e mia. Unë jam bë
3 operacion 27 herë deri në 2018 jam operuar. Jo që s'jam marrë
4 me atë punë. Më vjen shumë keq. Jo, jo.

5 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do të doja të tregoj provën
6 materiale P00161 që është në fakt dokument konfidencial, është
7 në disa gjuhë. Kështu që do ju kërkoja ta hapnit dy herë, nëse
8 është e mundur.

9 Py. Pa lexuar emrat, zoti Gucati, të akuzuarve në këtë
10 çështje, a mund të na thoni nëse e njihni gjykimin lidhur me
11 këta të akuzuar?

12 Pë. Jo, s'kam marrë pjesë asnjë seancë. Të gjithë i njoh po
13 s'kam marrë pjesë në asnjë seancë të tyre për gjykimin e tyre.

14 Py. A e dinit se ky gjykim -- a e dini se u krye ky gjykim,
15 se ndodhi ky gjykim?

16 Pë. Po, po e di që ky gjykim ka përfunduar. Dikush kanë
17 vuajtur dënimin, ka qenë i dënum. Tëra që i flas, i flas
18 përmes shtypit dhe kam qenë kryetar i veteranëve në atëkohë në
19 Skënderaj. Është e vërtetë. Disa i liruar, me sa gabo, të
20 pafajshëm mbas një kohe. Disa kanë vuajtur dënimin. Kështu që
21 po. Ky gjykim ka zgjatë goxha shumë, nëse s'gabo. Gjykimi ka
22 qenë publik e në Kosovë në atë kohë.

23 Py. Pa përmendur emrat, personat që u akuzuan në këtë proces
24 a ishin anëtarë të lartë të UÇK-së, për shembull shohim tre të
25 parët, për shembull.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 86

1 Pë. Kurrë në jetë me ta s'kam pasë kurrëgjë gjatë luftës. Jo,
2 unë nuk e di për ato, mu më pyet kot. Unë kam qenë në fshatin
3 tim, qysh të kam të tregu dhe jo më pyet kot për ashtu.

4 Py. Zoti Gucati, ju jeni kryetari i OVL UÇK-së. Nuk jeni në
5 gjendje të na thoni nëse janë anëtarë të UÇK-së apo jo?

6 Pë. Të lutem, unë jam kryetar i veteranëve të Ushtrisë
7 Çlirimtare të Kosovës, s'jam unë kryetar t'ia ndaj gradat kush
8 është kapiten apo kush është major. Unë jam kryetari i
9 Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo pyetje mu më
10 befason. S'jam unë ai që i përcakton gradat ushtarake kush, ku
11 ka qenë. Unë kam qenë një ushtar i thjeshtë, kështu që, jo për
12 grada nuk i njohë.

13 Py. Po a i konfirmoni se këto tre personat e parë që janë
14 përmendur këtu ishin anëtarë të UÇK-së? Mund të na e
15 konfirmoni këtë, mund të na e pohoni këtë, e konfirmoni këtë?

16 Pë. Të gjithë kanë qenë pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të
17 Kosovës. Edhe unë kam qenë pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të
18 Kosovës. Të gjithë kanë qenë këta. Po gradat e ato, nuk e di.
19 Kështu që s'jam marrë unë. Unë kam qenë ushtar i thjeshtë, si
20 çdo pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

21 Py. Faleminderit.

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do të doja t'i referohesha faqes
23 4 në të majtë të ekranit, pra, dhe faqes 4 po në të djathtë të
24 faqes që i korrespondon.

25 Zonja Sekretare e Gjykatës nëse mund të shkoni më poshtë.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 87

1 1, 4 në anglisht dhe 1, 4 në shqip. Pra, që është faqja që ka
2 SITF00372151.

3 Py. Në këtë urdhër lexohet, thuhet:

4 "Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranon se mund të ketë
5 rrezik serioz në këtë lëndë për shkak të kushteve të
6 përgjithshme që janë prezentë në Kosovë dhe për shkak të
7 rrethanave individuale të dëshmitarëve dhe palëve të dëmtuara
8 në këtë rast konkret. Frikësimi i dëshmitarëve në gjykimet e
9 Krimeve të Luftës akoma mbetet problem i rëndë në Kosovë.
10 Sipas raportit të OSBE-së me të cilin vlerësohen 10 vjetët e
11 kaluara të gjykimeve në Kosovë, çështja e mbrojtjes së
12 dëshmitarëve ka minuar ndjekjen e rasteve të Krimeve të Luftës
13 më shumë se çdo çështje.

14 "Kjo çështje është e përhapur në Kosovë për shkak të
15 madhësisë së vogël gjeografike të vendit dhe të natyrë së
16 zgjeruar të strukturave familjare të cilat bëjnë që
17 dëshmitarët të jenë të rrezikuar ndaj kërcënimeve që u bëhen
18 anëtarëve të familjes. Gjithashtu, frika e kërcënimeve duket
19 se shtohet në rastet kur përfshihen ish-pjesëtarët e forcave
20 të UÇK-së pasi që publiku i gjerë i konsideron luftëtarët e
21 UÇK-së si heronj kombëtarë dhe si të tillë 'të paraprekshëm'.

22 Pas vdekjes së dëshmitarit kyç në një rast të krimeve të
23 luftës në Kosovë më 28 shtator 2011..." - Më fal. Do të dua ta
24 përfundoj.

25 Z. REES: [Përkthim] Ky është një aktgjykim që ka kaluar

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 88

1 dhjetë vjet. Është i vjetër mbase dua ta shpjegoj njëherë
2 çfarë lidhje ka.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do ta
4 lejojmë ta përfundojë njëherë së lexuari dhe pastaj mund të
5 ngrini kundërshtimin tuaj. Atëherë kundërshtimi juaj hidhet
6 poshtë.

7 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] "Pas vdekjes së dëshmitarit kyç
8 në një rast të Krimeve të Luftës në Kosovë më 28 shtator 2011,
9 Zyra e Komisionit të Lartë për të Drejtat e Njeriut ka
10 shprehur shqetësimet e saj lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve
11 në Kosovë dhe ka kërkuar që të vendoset një sistem i pavarur
12 për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të viktimave. ZKLDNJ-ja ka
13 thënë se vetëm një sistem efikas dhe i pajisur mirë me resurse
14 për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, do të mund të
15 ndihmonte për të sjellë drejtësi te viktimat dhe për t'i dhënë
16 fund mosndëshkimeve për shkeljet e shkuara, e kaluara në
17 Kosovë".

18 A jeni dakord, zoti Gucati, se ky urdhër ka një përshkrim
19 të klimës së frikësimit të dëshmitarëve në proceset gjyqësore
20 ndaj anëtarëve të UÇK-së? Jeni dakord apo jo?

21 Pë. Më së pari, s'kam të bëj fare me këtë dokument. Se
22 ky ka ndodhë para dhjetë vite, në mos gabofsha, dikund në 2011
23 ky rast. Kështu që, nuk e di për çka e keni fjalën. Gjithmonë
24 kam qenë kundër atyre njerëzve që mendojnë ta kërcënojnë dikën
25 dhe prapë jam kundër atyne.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 89

1 Dhe gjithmonë duhet të ruhet personaliteti i çdo njeriu
2 dhe identiteti i tina. Kjo është e vërtetë. I ke dhe në
3 incizime. Ka fakte që kam thënë gjithmonë. Kështu që, me këtë
4 dokument unë as që merrna. Se s'kam qenë në atëkohë kryetar,
5 punoja në Prishtinë, në 2011. Kështu që nuk e di. As kam
6 dëgjuar rast. Nuk kam dëgju se s'ka qenë në domenin tim që të
7 interesohna diçka për këtë punë.

8 Py. Ju thatë që jeni kundër atyre personave që
9 frikësojnë të tjerët. Pra, ju jeni në dijeni se ekzistojnë, se
10 ka shembuj, se ka persona që frikësojnë të tjerë, pra, sa u
11 takon këtyre lloj gjykimeve; apo jo?

12 Pë. Jo, jo. S'është e vërtetë se jam në dijeni unë. As që kam
13 dëgjuar, të thashë. Të thashë edhe para një minute. As që kam
14 dëgjuar. S'jam në dijeni unë. Në çka po bazohesh si jam unë në
15 dijeni? Tregoma faktin ti që u bazove që unë thashë që jam në
16 dijeni. Nuk jam në dijeni fare. S'është e vërtetë që Hysni
17 Gucati është në dijeni X apo Y është kërcënuar. Jo, s'është e
18 vërtetë.

19 Py. Nuk po ju pyes për këtë person apo X apo Y. Po ju pyes ju
20 e kuptoni, pra, jeni në dijeni se në përgjithësi tek gjykimet
21 në Kosovë ndaj anëtarëve të UÇK-së janë ndikuar nga problemet
22 e përsëritura që kanë lidhje me frikësimin e dëshmitarëve? A
23 jeni në dijeni se ka ndodhur?

24 Pë. Jo.

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Doja të tregoja, të shfaqej në

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 90

1 ekran dokumenti SPOE00248303-00248404, i cili është dokument
2 konfidencial.

3 Py. Zoti Gucati, pa përmendur emrat, mund t'i shihni me
4 shkronja të zeza këtu. A e dini ju nëse personat që janë
5 përmendur në faqen e parë të këtij dokumenti i korrespondojnë
6 anëtarëve të UÇK-së të cilët ishin, u gjykuan, ishin pjesë e
7 gjykimit?

8 Pë. Jo, nuk e di. Nuk e kam ditë. Kjo është dikund -- kjo 10
9 gusht 2006. Mu në q'atë kohë, në 15 tetor mu më ka vdek vajza
10 dhe isha në Shkup, në spital me vajzën time në 2006, i tërë
11 viti, si të thashë nga leukemia. Kështu që, s'jam në dijeni
12 fare hiç. Hiç. Kjo është. Edhe këtë ta dokumentoj me të gjitha
13 dokumentacionet e vajzës se isha në Shkup tërë vitin prej
14 2005, dikun në tetor 2005 deri në tetor 2006. Më 15 tetor që
15 më ka vdek vajza 8-vjeçare nga leukemia. Kështu që, s'jam fare
16 në këtë dijeni. S'jam fare. Të jem i sigurtë s'jam fare se i
17 kisha problemet e mia private, që thashë edhe ma herët,
18 shëndetësore dhe me veten dhe me vajzën. Kështu që s'jam në
19 dijeni fare me këto. S'jam në dijeni.

20 Z. REES: [Përkthim] A mund t'ju pyes a ka numër P ky
21 dokument?

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Është në listën e provave
23 materiale të ZPS-së.

24 Z. REES: [Përkthim] Pra, është pranuar?

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo, nuk është pranuar.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdim)

Faqe 91

1 Dhe pyetja e fundit, se pastaj duhet të kalojmë në seancë
2 private. Mbase mund ta bëjmë pas pushimit.

3 Py. Emri i parë me shkronja të theksuar në të zezë, që ju
4 shihni, zoti Gucati, në paragrafin e parë. E njihni këtë
5 person?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mos e
7 përdorni emrin, ju lutem. Mos e thoni emrin.

8 I AKUZUARI GUCATI: Rrjedh prej një familje shumë të
9 madhe. Një babë shumë të fortë, familje e burgosur nga forcat
10 serbe me vite të tëra. Kështu që --

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
12 Gucati --

13 I AKUZUARU GUCATI: Jo që e njoh unë, po e njohin i tërë
14 populli dhe tërë qytetarët e Kosovës këtë emër për kontributin
15 e tij për vendin e vet.

16 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

17 Py. Është ish-anëtar i UÇK-së; apo jo?

18 Pë. Ky është i regjistruar si veteran lufte në Organizatën e
19 Veteranëve dhe unë s'muj ta mohoj atë punë. Po, është anëtar i
20 Organizatës së Veteranëve të Luftës dhe ish-pjesëtar i
21 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

22 Py. Faleminderit.

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] I nderuar, mendoj se tani mund të
24 bëjmë pushimin edhe do ta rifilloj pas pushimit këtë pjesë.

1 Faleminderit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A bëjmë
3 pushimin ne për drekë? Do bëjmë pushimin e drekës. Do kthehemi
4 në orën 14.30.

5 Z. REES: [Përkthim] Doja të ngrija dy çështje që i
6 përmendëm pak sot në mëngjes.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pas
8 pushimit të drekës do t'i diskutojmë.

9 --- Pushimi i drekës fillon në orën 12.59

10 --- Seanca rifillon në orën 14.30

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Duket se
12 kemi hasur probleme me lidhjen me njësinë e paraburgimit dhe
13 zoti Haradinaj, për këtë arsye, nuk mund të jetë i pranishëm
14 për të vëzhguar. Po punojnë që ta zgjidhin. Atëherë, ne
15 mendojmë t'u japim një gjysmë ore dhe nëse nuk e rivendosin
16 dot lidhjen do të na duhet që ta ndërpresim këtu seancën për
17 sot, pastaj dhe të vijojmë nesër sepse, sigurisht, që zoti
18 Haradinaj duhet që ta ndjekë, duhet ta përcjellë zhvillimin.

19 Ka dikush pyetje?

20 Z. REES: [Përkthim] Jo. I nderuar Gjykatës, nëse mund të
21 më lejoni të ngre dy çështje të cilat do të doja që t'i
22 ngrija.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
24 Cadman, klienti juaj nuk do ta dëgjojë dot këtë diskutim. Doni
25 që ju ta lejoni zotin Rees t'i ngrejë këto dy çështje që

1 dëshiron t'i ngrejë?

2 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] [Nuk ka
3 përkthim].

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Nuk ju
5 dëgjoj mirë.

6 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk jam në
7 rregull.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ah, po.
9 Nuk kam vendosur kufjet.

10 Tani e kuptoj zonjën Bolici pse nuk kuptonte sot në
11 mëngjes.

12 Ju kërkoj ndjesë, zoti Cadman. Mund të vazhdoni.

13 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë nuk kam
14 pasur mundësi që të flas me zotin Haradinaj gjithë ditën sot,
15 as gjatë pushimit të drekës. E di që po përpiqen që të
16 rregullojnë çështjen. E di që zoti Haradinaj do të donte që
17 t'i përcillte punimet.

18 Nuk e di nëse ka ndonjë çështje të vogël që zoti Rees
19 dëshiron ta ngrejë, mbase s'do këtë problem. Por unë nuk kam
20 pasur mundësi që të flas me zotin Haradinaj për këtë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në rregull
22 atëherë. Ju kuptova. Atëherë, vendimi sipas rregullit 102(3)
23 për një çështje që ende nuk ka marrë përgjigje do të
24 protokollohet sot.

25 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit, zoti Gjykatës.

1 Shkurtimisht nëse mundem të parashtroj çështjen që desha
2 të ngre, mbase edhe zoti Cadman pastaj -- unë nuk e di se deri
3 ku zoti Cadman është në dijeni të çështjes që dua të ngre unë.
4 Është çështje administrative, e cila do të na japë mundësi që
5 të planifikojmë dëshmitarët e tjerë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Se doni të
7 parashikoni kohën e dëshmitarëve të tjerë.

8 Z. REES: [Përkthim] Pikërisht.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
10 Cadman, keni kundërshtim për këtë?

11 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, po. Pa
12 problem. Edhe ne do të donim ta dinim përgjigjen e kësaj.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirë ju
14 mund t'i mbani shënim këtu. Do të jetë dhe transkripti, nëse
15 klienti juaj dëshiron t'i shikojë, mund t'i shikosh shënimet
16 më pas.

17 Z. REES: [Përkthim] Pra, ne e kemi bërë të qartë sesa i
18 takon dëshmitarëve të tjerë të Mbrojtjes së zotit Gucati, ne
19 dëshirojmë të përfitojmë nga mundësia që na jep ne rregulli
20 105(4) sa i takon përshpejtimit të punimeve.

21 Ne propozojmë që në lidhje me secilin prej këtyre
22 dëshmitarëve kur të identifikohen t'u kërkojmë që të
23 identifikojnë deklaratën e dëshmitarit për të konfirmuar nëse
24 kjo reflekton saktë deklarinimin që ka bërë dhe nëse ai ose ajo
25 do të thoshte nëse do t'i bëheshin pyetje, në vend të pyetjeve

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Çështje procedurale

Faqe 95

1 të bëra drejtpërdrejtë nga pala thirrëse të lexohet deklarata,
2 me përjashtim të atyre pjesëve për të cilat ZPS-ja mund të
3 këtë kundërshtim dhe besoj kjo mund të vlejë dhe për
4 kundërpyetjet.

5 Dhe kjo mund të sigurojë që të përfundojë Mbrojtja e
6 zotit Gucati brenda periudhës së caktuar.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kjo vlen
8 për të gjithë dëshmitarët e mbetur?

9 Z. REES: [Përkthim] Po, mund të ketë disa pyetje. Për
10 shembull, me një dëshmitare, mund të përdorim një incizim në
11 video të cilën ajo e përmend në deklaratë. Po në përgjithësi,
12 do të përpiqemi që të paraqesim deklaratën me shkrim në vend
13 të bërjes së pyetjeve.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
15 Cadman, besoj s'keni kundërshtim për këtë?

16 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Mendoj se ky
17 është qëndrimi i duhur.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja
19 Bolici, ju lutem.

20 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] E vetmja gjë është sipas vendimit
21 për zhvillimin e procedurës, është përmbledhja e deklaratës që
22 duhet lexuar dhe jo tërësia e përmbledhjes.

23 PËRKTHYESI: Nuk ka mikrofoni Gjykatësi.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Më duket
25 se është zgjidhje që pranohet se s'ka kundërshtim.

1 Z. REES: [Përkthim] Vetë deklaratat janë koncize. Ne
2 propozojmë të lexojmë ato deklarata me kusht që të mos lexojmë
3 ato pjesë për të cilat ZPS-ja i ka identifikuar se ka
4 kundërshtim.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po thoni
6 që doni një përmbledhje më vete nga ato që keni?

7 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mendoj që kjo do binte ndesh me
8 efikasitetin e procedurës nëse do t'i merrnim me imtësi
9 deklaratat e të gjithë dëshmitarëve në vend të leximit të një
10 përmbledhje koncize.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Por
12 pranimi i dokumentit, nëse do të pranohej i gjithë dokumenti,
13 me përjashtim të pjesëve për të cilat ju keni kundërshtim.

14 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nuk do të kisha kundërshtim për
15 pranimin sipas rregullit 154, me përjashtim të paragrafëve që
16 konsiderohen si të parëndësishme.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund të
18 përgatisni një përmbledhje të shkurtër të secilës? Apo kjo bie
19 ndesh me qëllimin tuaj.

20 Z. REES: [Përkthim] Po, po ato janë koncize, nuk ka
21 kuptim.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Sigurisht.
23 Nëse mund të hiqni disa pjesë të parëndësishme.

24 Z. REES: [Përkthim] Patjetër.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Unë e

1 kuptoj shqetësimin tuaj, zonja Bolici, po mendoj se mund të
2 paraqiten për pranim në provat gjyqësore deklaratat, me
3 përjashtim të pjesëve të cilat ka kundërshtim.

4 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Vërej, i nderuar Gjykatës, se
5 disa prej deklaratave kanë shumë paragrafë për të shkuarën e
6 dëshmitarëve, historikun, njohuritë e tyre e tjerë e tjerë,
7 kjo është një çështje e cila do të donim që të mbahej
8 parasysh.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po e kemi
10 vënë re dhe do ta mbajmë parasysh këtë gjë.

11 Për shembull, një pjesë e materialeve, nga disa prej
12 dëshmitarëve, zoti Rees, kanë të bëjnë me historikun e tyre
13 gjatë luftës. Unë e di që ju e keni -- që ju i përmendni këto
14 për një arsye tjetër po për ne janë thjesht historik i së
15 shkuarës.

16 Z. REES: [Përkthim] Ne dëshirojmë që deklaratat të
17 pranohen plotësisht. Unë mund t'u hedh një sy përsëri dhe
18 mbase mund t'i shkurtoj paksa.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po
20 sigurisht do ta shikojmë edhe ne. Do të marrim një vendim nga
21 ana jonë. Mund të vazhdojmë mbi këtë bazë.

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Më kanë sjellë në vëmendje ose në
23 bazë të seancave të përgatitjes me dëshmitarë të cilat na janë
24 informuar nga dje në sot, të paktën një prej dëshmitarëve ka
25 thënë se asaj nuk i kujtohet shumë mirë se çfarë ka deklaruar

1 në deklaratën e mëparshme. Është DW1242. Për këtë duhet të
2 verifikojmë në Gjykatë se çfarë ka thënë për të parë nëse
3 deklaratata e saj është e saktë apo jo.

4 Z. REES: [Përkthim] Në fakt, ne nuk besojmë se është ky
5 shënimi, pra, është ky dokumenti që është nxjerrë. Po, nëse
6 po, atëherë zonja Bolici mund të bëj pyetjet e saj lidhur me
7 këtë.

8 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Një
10 çështje tjetër është dëshmia e zotit Bowden.

11 Kujtuam se ju kishit sugjeruar që faktet për të cilat
12 palët pajtohen janë të mjaftueshme, keni rënë dakord me
13 Prokurorinë për këtë. Do të vazhdoni me këtë?

14 Z. REES: [Përkthim] Kemi bërë korrespondencë me
15 Prokurorinë për disa prej fakteve për të cilat propozohen, për
16 të cilat ne do të pajtohemi. Është punë në proces. Kemi
17 filluar, po, një sërë prej dokumenteve që do të donim që t'i
18 paraqisnim, jo përmes dëshmitarëve dhe jo përmes paraqitjes së
19 fakteve për të cilat palët pajtohen.

20 Pra, kjo është një punë në proces, akoma nuk ka mbaruar.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja
22 Bolici.

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Sa i takon dëshmisë së zotit
24 Bowden, sugjerimet tona në parashtrimin e protokolluar është
25 që të pranojë deklaratën sipas rregullit 153, nëse Mbrojtja

1 dëshiron që ta paraqesë si provë materiale sipas rregullit
2 153.

3 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar
4 Gjykatës, nuk e di sesi më dëgjoni?

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po prit se
6 kemi një diskutim me zoti Rees.

7 Z. REES: [Përkthim] Po në fakt, është një çështje e
8 drejtpërdrejtë. Ne do të jemi në lidhje me Prokurorinë, do të
9 përpiqemi që ta zgjidhim këtë pa ja kaluar barrën Trupit
10 Gjykues.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
12 Cadman dëshiron të thotë një gjë.

13 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ky është një
14 kundërshtim nga ana ime se unë kujtoja se po flisni për
15 çështje administrative po tani po flasim për gjëra materiale
16 të cilat kanë të bëjnë me thelbin, zoti Haradinaj do të donte
17 që ta përcillte.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kini
19 parasysh që nëse dëshironi që të presim dhe të diskutojmë këto
20 gjëra në prani të tij mund të veprojmë dhe kështu. Më dëgjuat?

21 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po. Po nuk
22 është ai këtu që ta dëgjoj.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirë, pra,
24 në rregull. Nëse nuk na thërrasin këto 20 minutat e ardhshme,
25 do të thotë që për sot kemi përfunduar. Qëndroni këtu afër.

1 Zonja Bolici, po.

2 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
3 Gjykatës. Dëshiroj që t'ju jap një njoftim të shkurtër, do ta
4 përsëris edhe kur të jetë i pranishëm zoti Haradinaj.

5 Në lidhje me parashtrimin e protokolluar të Mbrojtjes së
6 Gucatit me numër 478, Prokuroria nuk ka kundërshtim që të
7 shtohet ky material në listën e provave materiale, rezervojmë
8 që kundërshtimet tona t'i paraqesim në momentin kur këto
9 materiale do të kërkohet që të pranohen në provat e procesit.
10 Do të kishim kundërshtime për pranueshmërinë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti Rees.

12 Z. REES: [Përkthim] Jam mirënjohës

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju
14 kërkujmë ndjesë atëherë të gjithëve. Nëse s'keni gjë tjetër,
15 do t'ju informojmë në orën 15.00 atëherë, nëse e kemi mbyllur
16 punimet për sot apo jo. Faleminderit.

17 --- Seanca përfundon në orën 14.41

18

19

20

21

22

23

24

25